SHËRBIME ME BAZË KOMUNITARE PËR FËMIJËT ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Save the Children

BASHKIA VLORE

BASHKIA DURRËS

NDIHMONI JETËN SHOQATA HELP THE LIFE ASSOCIATION

Analiza e praktikave më të mira

Save the Children

BASHKIA DURRËS

BASHKIA VLORE

NDIHMONI JETËN SHOQATA HELP THE LIFE ASSOCIATION

SHËRBIME ME BAZË KOMUNITARE PËR FËMIJËT ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Analiza e praktikave më të mira

Përgatiti: Edlira HAXHIYMERI

Botimi i këtij raporti u mundësua nga Save the Children

Save the Children beson se çdo fëmijë meriton një të ardhme të mirë. Në botë dhe në Shqipëri, ne ndihmojmë fëmijët të kenë një fillim të mbarë në jetë, mundësi për të mësuar dhe mbrojtje ndaj cdo rreziku. Ne bëjmë më të mirën për fëmijët - çdo ditë dhe në kohë krize –për të sjellë ndryshime në jetën e tyre dhe të ardhmen e përbashkët.

Autori:
Edlira Haxhiymeri, Prof/Dr e Shkencave Sociale

Grupi i Punës:
Irena Celaj, Oficere Projekti, Save the Children
Edlira Ngjeçi, Menaxhere Programi, Save the Children

TIRANË, 2018

Ky studim u prodhua në kuadër të projektit "Shërbime me Bazë Komunitare për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara", i cili zbatohet nga Save the Children në partneritet me shoqatën "Ndihmoni Jetën" dhe në bashkëpunim me Bashkinë Vlorë dhe Durrës. Ky projekt është pjesë e iniciativës rajonale që synon të fuqizojë fëmijët me aftësi të kufizuara të zhvillojnë potencialin e tyre, të praktikojnë pavarësinë dhe gëzojnë gjithëpërfshirjen. Gjithashtu fuqizon familjet dhe mobilizon komunitetet për të siguruar që fëmijët me aftësi të kufizuara të marrin shërbime cilësore që ata kanë nevojë. Projekti zbatohet njëkohësisht në Shqipëri, Armeni, Bosnje & Hercegovinë, Gjeorgji dhe Kosovë.

@Të gjitha të drejtat të rezervuara. Përmbajtja e këtij botimi mund të përdoret apo kopjohet lirisht nga specialistët e fushës, por jo për qëllime fitimprurëse, me kusht që çdo riprodhim të shoqërohet me njohjen e Save the Children si burim.

Këndvështrimet e autorit të këtij botimi jo domosdoshmërisht pasqyrojnë pikëpamjet e Save the Children.

Tabela e përmbajtjes

PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE 5

1. HYRJE 9
   1.1. Paraqitja e problemit 9
   1.2. Qëllimi dhe objektivat 11

2. METODOLOGJIA 13
   2.1. Pjesëmarrësit në studim 13
   2.2. Instrumentat për mbledhjen e të dhënave 14
   2.3. Analiza e të dhënave 14

3. RISHIKIMI I LITERATURËS 15
   3.1. Baza ligjore 15
      3.1.1. Dokumenta ndërkombëtare 15
      3.1.2. Dokumenta vendase 16
   3.2. Modelet e përkujdesit për fëmijët me aftësi të kufizuara 17

4. PREZANTIMI I GJETJEVE SIPAS FUSHAVE TË INTERESIT - REZULTATE DHE DISKUTIME 19
   4.1. Praktika të mira në aspektin politik dhe ligjor 19
   4.2. Praktika të mira në funksion të qëndrueshmërisë së shërbimit 20
   4.3. Praktika të mira në aksesimin e shërbimeve me bazë komunitare të fëmijëve me aftësi të kufizuara 25
   4.4. Praktika të mira në aspektin e cilësisë së shërbimit me bazë komunitare për fëmijët me aftësi të kufizuara 28
   4.5. Praktika të mira në funksion të arsimit gjithëpërfshirës 32
   4.6. Praktika të mira të shërbimeve me bazë komunitare përsa i përket pjesëmarrjes së prindërve 34
   4.7. Praktika të mira të shërbimeve me bazë komunitare në aspektin e investimit për përmirësimin e kapaciteteve të profesionistëve 35
   4.8. Praktika të mira të shërbimeve me bazë komunitare për FAK për fuqizimin e kapaciteteve të aktorëve vendorë dhe rritjen e bashkëpunimit mes tyre 36
   4.9. Shqetësime dhe sugjerime 38
      4.9.1. Shqetësime 38
      4.9.2 Sugjerime 38

5. PËRFUNDIME 39

6. REKOMANDIME 41

BIBLIOGRAFIA 42

Akronime

SHBK - Shërbim me Bazë Komunitare

KDF - Konventa e të Drejtave të Fëmijëve

KDPAK - Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara

FAK - Fëmijë me Aftësi të Kufizuara

PAK - Persona me Aftësi të Kufizuara

DAR - Drejtoria Arsimore Rajonale

QV - Qeveri Vendore

KMPV - Komisioni Mjekësor i Përcaktimit të Verbërisë

KMCAP - Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë

MARS - Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit

MSHMS - Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

OJQ - Organizata Joqeveritare

PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

Analiza e praktikave më të mira në zbatimin e Projektit 'Shërbime me bazë komunitare për fëmijët me aftësi të kufizuara" është përgatitur me kërkesën e Save the Children në kuadër të këtij projekti. Projekti "Shërbime me bazë komunitare për fëmijët me aftësi të kufizuara" mbështetet nga Fondacioni The Margaret A. Cargill Philanthropies dhe është zbatuar nga Save the Children për një periudhë 3 vjeçare, në partneritet me organizatën lokale 'Ndihmoni Jetën' dhe në bashkëpunim me bashkitë e Durrësit dhe Vlorës.

Ky projekt ka mundësuar ngritjen e dy qendrave për shërbime me bazë komunitare, të cilat ofrojnë shërbime cilësore për fëmijët me aftësi të kufizuara.

Nëpërmjet identifikimit të praktikave më të mira në zbatimin e këtij projekti synohet inkurajimi i replikimit të praktikave të tilla edhe nga aktorë të tjerë, institucione të qeverisjes vendore, organizata lokale, organizata të tjera të shoqërisë civile, donatorë vendas dhe të huaj. Kjo analizë pritet t'i shërbejë edhe punës së mëtejshmë të Save the Children në mbrojtjen dhe përmirësimin e jetës së fëmijëve me aftësi të kufizuara në Shqipëri.

Të dhënat më të fundit tregojnë se ka një shifër prej 14 578 fëmijë me aftësi të kufizuar që janë të identifikuar përmes shërbimeve dhe Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë. Numri i fëmijëve me aftësi të kufizuar llogaritet edhe më i lartë pasi është evidentuar se ka shumë prej tyre që janë jashtë skemës së ndihmës për arësye të ndryshme.

7,8% e fëmijëve të evidentuar me aftësi të kufizuara marrin shërbime nga qendra sociale.

66% e fëmijëve me aftësi të kufizuar jetojnë në familje me të ardhura të ulëta.

58% e nënave dhe **33%** e baballarëve janë të papunë.

55,0% e prindërve raporton se shpenzimet e nevojshme për marrjen e shërbimit për këta fëmijë janë të papërballueshme, ose krejtësisht të papërballueshme për ta.

1 në 3 fëmijë me aftësi të kufizuar përballet me diskriminim në shërbimet publike, si ato shëndetësore ose shoqërore.

Është e vërtetë se gjatë viteve të fundit ka pasur shumë zhvillime pozitive në plotësimin e kuadrit ligjor dhe të politikave për personat me aftësi të kufizuara në Shqipëri. Por kjo nuk mjafton. Ajo çfarë mungon momentalisht është angazhimi i institucioneve të qeverisjes vendore, edhe në kuadrin e reformës administrative dhe decentralizimit të shërbimeve sociale, në veprime konkrete dhe trajtimi i sfidave dhe problematikave të evidentuara duke u mbështetur në modelet pozitive dhe praktikat më të mira.

Vlerësimi i praktikave më të mira në kuadrin e projektit "Shërbime me bazë komunitare për fëmijët me aftësi të kufizuara" është fokusuar kryesisht në tre drejtime:

- Ofrimi i shërbimeve direkte për fëmijët me aftësi të kufizuara;
- Mbështetja e familjeve të fëmijëve me aftësi të kufizuara në mënyrë që ata të mund të advokojnë për të drejtat e fëmijëve të tyre;
- Rritja e kapacitetit të autoriteteve përkatëse vendore.

Vlerësimi përpiqet të ofrojë informacion në fushat e mëposhtme:

- Vlerësim i eficences, efikasitetit, qëndrueshmërisë dhe ndikimit që kanë patur shërbimet e ofruara përmes këtij projekti;
- Si e vlerësojnë përfituesit kryesorë: fëmijë, prindër dhe aktorë lokalë ndërhyrjen që ofron projekti në funksion të nevojave të tyre;
- Matjen e ndikimit që ka patur ndërhyrja në funksion të nevojave lokale;
- Identifikimi dhe përmbledhja e pikave të forta dhe të dobta të modeleve të ndërhyrjes dhe të bëjë rekomandime që mund të ndihmojnë në hartimin dhe zbatimin e projekteve që adresojnë nevojat e fëmijëve me aftësi të kufizuara për të aksesuar shërbimet e integruara në qendrat e kujdesit për fëmijë, zhvillimin e aftësive të tyre, praktikimin i pavarësisë dhe gëzimin e përfshirjes;
- Të ekzaminojë se si projekti ka adresuar çështje të ndërthurura si promovimi i të drejtave të njeriut dhe të drejtave të fëmijëve, arsimi gjithëpërfshirës, antidiskriminimi, jodhunës, barazia gjinore dhe rezilienca;
- Identifikimi i mësimeve nga kjo ndërhyrje, rreziqet për qendrat e shërbimeve duke vlerësuar situatën nga këndvështrimi i fëmijëve, prindërve, dhe partnerëve të tjerë në komunitet;
- Identifikimi i faktorëve (ligjorë dhe dokumentave politikë, proceseve, ngjarjeve, komunikimi, mjedisi social/demografik) të cilët ndikojnë ndjeshëm në zbatimin dhe arritjen e rezultateve të dëshiruara nga projekti.

Metodologjia

Për realizimin e këtij vlerësimi studjuesja është mbështetur në metodën cilësorë të studimit. Janë analizuar të dhëna parësore dhe dytësore dhe janë shfrytëzuar teknika si: intervista gjysëm të strukturuara, fokus grupe dhe observime. Për qëllime të analizës janë shfrytëszuar burime të literaturës së fushës si dhe një sërë raportesh e botimesh që pasqyrojnë situatën e PAK në vend.

Gjetjet kryesore

Projekti i Save the Children për ngritjen e qendrave të shërbimeve me bazë komunitare për fëmijët me aftësi të kufizuara në bashkëpunim me organizatën Ndihmoni Jetën dhe bashkitë e Durrësit dhe Vlorës është një model risi në shërbimet komunitare.

Qendrat janë një përpjekje serioze për të plotësuar detyrimet që burojnë nga dokumentat ligjorë dhe politikë në vend për zbatimin e të drejtave të PAK, veçmas të FAK.

Shërbimi gërsheton punën individuale me fëmijët me aftësi të kufizuara, me punën me prindërit për informimin dhe anagazhimin e tyre në mbrojtje të të drejtave të fëmijëve të tyre dhe punën me partnerët lokalë për rritjen e kapaciteteve vendore në trajtimin e çështjeve të aftësisë së kufizuar.

Shërbimi është i plotë pasi ai gërsheton një tërësi ndërhyrjesh për fëmijët duke filluar me terapitë individuale, punën në grup, fizioterapinë, etj.

Modeli i ofruar siguron qëndrueshmëri të shërbimit pasi bashkitë e Durrësit dhe Vlorës kanë një marrëveshje bashkëpunimi me Save the Children, marrëveshje kjo që ka siguruar angazhimin gradual të bashkive për të marrë nën juridiksion shërbimin e qendrave pas përfundimit të projektit.

Aktualisht bashkitë përveç se kanë vënë në dispozicion mjediset e qendrave, kanë filluar të mbulojnë edhe shpenzimet për pagat e disa punonjësve të qendrave (bashkia e Durrësit) dhe të paguajnë disa kosto administrative (bashkia Vlorë).

Modeli i ofruar mundëson aksesin e shërbimeve nga fëmijë të familjeve me probleme ekonomike, pasi shërbimi është falas.

Qendrat e shërbimeve janë të vendosura në zemër të zonave të banuara duke e afruar shërbimin pranë njerëzve në nevojë.

Shërbimi i ofruar nga qendrat për shërbime me bazë komunitare për fëmijët me aftësi të kufizuara përbën një komponent të rëndësishëm në fushën e AK pasi i bashkëngjitet përpjekjeve për realizimin e arsimit gjithëpërfshirës. Shërbimet në qendra kanë përmirësuar ndjeshëm vijueshmërinë në shkolla të fëmijëve që ndjekin qendrat.

Qendrat e shërbimit me bazë komunitare për fëmijët me aftësi të kufizuara në Durrës dhe Vlorë janë kthyer në qendra të punës me prindërit për informimin, trajnimin dhe organizimin e tyre për të lobuar dhe advokuar në mbrojtje të të drejtave të fëmijëve të tyre. Tashmë prindërit në të dy qendrat kanë TASK Forcën dhe Bordin e tyre dhe janë duke bërë presion mbi bashkitë për buxhetin social.

Qendrat janë kthyer në epiqendra të rrjetit të aktorëve lokavë, qofshin këta publike apo jopublike.

Qendrat kanë investuar për rritjen e kapaciteteve profesionale të aktorëve lokalë (qeverisjes lokale por edhe profesionistëve - mësues, mësues ndihmës, psikologë, punonjës socialë, mjeke, etj) .

1. HYRJE

1.1. Paraqitja e problemit

Regjistrimi i fundit i popullsisë në Shqipëri (Censusi 2011), nxori në pah se 6,2% e popullsisë mbi moshën 15 vjeç ka një formë të aftësisë së kufizuar. Të dhënat e fundit të Shërbimit Social Shtetëror tregojnë se në gjithë vendin janë 140 840 persona me aftësi të kufizuara, ndër të cilët 14 578 janë fëmijë. Kjo shifër, përbën afërsisht 2% të numrit të fëmijëve në vend (n=738990).

Studimi më i fundit i realizuar nga World Vision dhe Save the Children, i cili synoi në matjen e përhapjes së aftësisë së kufizuar tek fëmijët, identifikoi se 10,4% e fëmijëve të grupmoshës 2-17 vjeç hasin të paktën një vështirësi të lartë për të kryer një aktivitet ose nuk arrijnë ta kryejnë fare atë.

Studimi tregoi gjithashtu se vetëm 7,8% e fëmijëve me aftësi të kufizuara në Shqipëri marrin shërbim nga qendra sociale.

Prevalenca është më lartë në familjet me të ardhura të pakta. 66% e fëmijëve me aftësi të kufizuar jetojnë në familje me të ardhura të ulëta, ndërsa 30% e tyre jetojnë në familje me të ardhura mujore të mesme.

Niveli i papunësisë së prindërve të fëmijëve me aftësi të kufizuar raportohet mjaft i lartë. 58% e nënave dhe 33% e baballarëve janë të papunë.

Vetëm 7,8% e fëmijëve me aftësi të kufizuar, kanë ndjekur një shërbim social gjatë 12 muajve të fundit.

55,0% e prindërve raporton se shpenzimet e nevojshme për marrjen e shërbimit për këta fëmijë janë të papërballueshme, ose krejtësisht të papërballueshme për ta.

Arsyet kryesore për mosndjekjen e shërbimeve sociale të vlerësuara nga prindërit, janë mospërballimi i kostove financiare që lidhen me marrjen e shërbimit (88,9%); mungesa e transportit (20,0%); mungesa e shërbimit në komunitet (8,9%); refuzimi i shërbimit (11,1%), si dhe cilësia e papërshtatshme e shërbimeve (8,9%).

1 në 3 fëmijë me aftësi të kufizuar përballet me diskriminim në shërbimet publike, si ato shëndetësore ose shoqërore.

Ratifikimi nga shteti shqiptar i Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (KDPAK), krijon detyrime të reja për Qeverinë Shqiptare në drejtim të: (a) ndryshimeve ligjore; (b) praktikave administrative; (c) qasjes ndaj aftësisë së kufizuar; (d) standardeve të një niveli më të lartë të garantimit dhe mbrojtjes së të drejtave e një cilësie më të mirë jetese të personave me aftësi të kufizuara. Gjatë viteve të fundit, në vend janë hartuar një sërë ligjesh dhe politikash, lidhur me promovimin dhe mbrojtjen e personave me aftësi të kufizuara si Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara, 2016 -2020[1], Strategjia e Mbrojtjes Sociale (2015-2020)[2], Dokumenti Politik për Përfshirjen Sociale (DPPS 2016-2020)[3], Ligji për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë (2014)[4], Ligji për Shërbimet

1. VKM nr.483, datë 29 qershor 2016, *"Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të kufizuara, 2016-2020"*.
2. VKM Nr. 1071, datë 23.12. 2015, *"Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të të Mbrojtjes Sociale, 2015-2010"*.
3. Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 87, datë 3.2.2016," Për miratimin e Dokumentit Politik të Përfshirjes Sociale 2016-2020".
4. Ligji nr. 93/2014 datë 28.07.2014, "*Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara*".

e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë (2016)[5]. Të gjithë këto dokumente, në masën që trajtojnë çështje të lidhura me personat me aftësi të kufizuara, kanë në themel të tyre vënien në jetë të orientimeve të dhëna në Konventën e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara, të ratifikuar në Dhjetor 2012, nga Qeveria Shqiptare. Pavarësisht se kuadri legjislativ ka njohur disa përmirësime ndër vite, është e rëndësishme të kihet në konsideratë që detyrimet ligjore u përkasin dhe duhet të vihen në jetë nga të gjitha nivelet e qeverisjes. Megjithatë, kuadri ligjor e politik, qasja e re dhe konceptet e KDPAK, shpeshherë, mbeten të panjohura në disa prej segmenteve në nivel qëndror, dhe aq më tepër në nivelin vendor.

Pavarësisht përpjekjeve dhe masave të marra për ndryshim, komuniteti i personave me aftësi të kufizuara, në mënyrë të veçantë FAK, ende vazhdojnë të hasin vështirësi, të cilat i pengojnë ata të jenë qytetarë me të drejta e mundësi të barabarta me të gjithë pjesën tjetër të shoqërisë. Ndër vështirësitë e identifikuara përmenden edhe mungesa e shërbimeve në komunitetet ku ata jetojnë si dhe mungesa e shërbimeve të lidhura me rehabilitimin dhe integrimin e tyre.

Disa iniciativa të organizatave të shoqërisë civile janë përpjekur të sjellin në vemendjen e aktorëve qendrorë dhe vendorë situatën lidhur me PAK dhe të kontribuojnë në përmirësimin e saj. E tillë ka qenë dhe iniciativa për hartimin e Planeve Sociale me fokus AK në 10 bashki të vendit. Janë rreth 50 000 PAK që jetojnë në këto 10 bashki, dhe 10% e tyre (pra rreth 5000) janë FAK.

Ajo që të bën përshtypje në studim është se ndërsa numri i PAK vazhdon të rritet (numri i FAK mbetet i lartë, shiko tabelën me të dhëna për vitet 2015-17), shërbimet e specializuara për këtë kategori lënë shumë për të dëshiruar.

Rajoni	Numri i fëmijëve nga 0-17 vjeç që marrin pagesën e paaftësisë në fund të vitit			% e fëmijëve nga 0-17 vjeç për çdo rajon që marrin pagesën e paaftësisë		
	2015	2016	2017	2015	2016	2017
Shqiperia	**17560**	**14742**	**14155**	**2,62%**	**2,26%**	**2,24%**
Berat	631	804	842	1,99%	2,67%	2,99%
Dibër	1278	1102	1097	3,80%	3,41%	3,59%
Durrës	1814	1845	1520	2,83%	2,89%	2,40%
Elbasan	2670	2073	2082	3,85%	3,10%	3,27%
Fier	1826	1397	1434	2,56%	2,03%	2,18%
Gjirokastër	350	268	249	2,32%	1,87%	1,90%
Korçë	1345	988	1020	2,60%	1,99%	2,17%
Kukës	636	655	626	3,00%	3,18%	3,19%
Lezhë	750	697	723	2,42%	2,32%	2,51%
Shkodër	1507	1293	1035	3,04%	2,72%	2,28%
Tiranë	3942	2932	2897	2,08%	1,56%	1,55%
Vlorë	811	688	630	1,99%	1,74%	1,64%

Burimi: Sherbimi Social Shteteror, 2018; INSTAT, 2018;

Hartuesit e Planeve Sociale në 10 bashki të vendit kanë identifikuar një problematikë të ngjashme edhe në këto bashki, ku veçojmë:

- Mungon në të gjitha bashkitë pika fokale për aftësinë e kufizuar, sipas parashikimeve ligjore që burojnë nga Ligji nr. 93/2014 datë 28.07.2014 "*Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara*".

5. Ligji Nr.121, datë 21.11.2016, "Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë"

- Numri i fëmijëve që marrin shërbime në këto bashki shkon deri në 670, që do të thotë se vetëm 13,5 % të numrit të fëmijëve të identifikuar dhe vlerësuar nga KMCAP me aftësi të kufizuara në këto 10të bashki (n=4946) marrin shërbime.
- Shërbimet ekzistuese janë të pamjaftueshme për të mbuluar nevojat e shumëllojshme të të gjitha kategorive të personave me aftësi të kufizuara. Shërbimet e identifikimit dhe ndërhyrjes së hershme janë krejtësisht të munguara.
- Parashikimet buxhetore për shërbime për PAK janë të limituara dhe nuk ka planifikime për parashikime në rritje.
- Nuk ka një rrjet formal të bashkëpunimit mes të gjitha institucioneve që janë përgjegjëse për të trajtuar çështjet e aftësisë së kufizuar në nivel vendor (arsimi, shëndetësia, punësimi, formimi profesional, shërbimet sociale, strehimi, transporti dhe infrastruktura, organizatat që ofrojnë shërbime dhe organizata të personave me aftësi të kufizuara).
- Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijës dhe Seksionet e barazisë gjinore dhe dhunës në familje, në bashkitë ku janë ngritur, nuk e kanë pjesë të punës së përditshme trajtimin dhe orientimin e problematikave të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe atë të grave me aftësi të kufizuara.

Të dhënat e mësipërme, por edhe një sërë të dhënash që janë mundësuar nga studimet e kryera vitet e fundit nga Save the Children (Analiza e situatës së shërbimeve për fëmijët me aftësi të kufizuara në Shqipëri, 2016) kanë theksuar nevojën për më shumë shërbime për FAK në mënyrë që ata të përfshihen në sistemin arsimor dhe të fitojnë aftësi të mira për jetën për të përmirësuar nivelin e tyre të jetesës dhe të familjeve të tyre.

Projekti 'Shërbimet me bazë komunitare për fëmijët me aftësi të kufizuara" mbështetur nga "The Margaret A. Cargill Philanthropies Foundation" dhe i zbatuar nga Save the Children në partneritet me organizatën lokale "Ndihmoni Jetën" është një përpjekje për të sjellë një model pozitiv në këtë drejtim.

1.2. Qëllimi dhe objektivat

Duke patur parasysh këtë nevojë, Save the Children në Shqipëri, në bashkëpunim me organizatën lokale "Ndihmoni Jetën" dhe bashkitë e Vlorës e Durrësit, është angazhuar në një projekt 3 vjeçar. Projekti në fjalë është një projekt rajonal, ku përfshihen 5 vende të rajonit: Bosnja & Hercegovina, Kosova, Shqiperia, Armenia dhe Gjerogjia.. Secili nga vendet në projekt ka specifikat e veta në zbatimin e të drejtave të fëmijëve me aftësi të kufizuara për një jetë më të mirë dhe pa diskriminim në varësi të kushteve social ekonomike, kulturës dhe traditës së krijuar në shërbime. Pavarësisht kësaj, të gjitha vendet i bashkon qëllimi për të respektuar dhe përmbushur nevojat e fëmijëve me aftësi të kufizuar, për të mbështetur prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe për të fuqizuar aktorët lokalë në krijimin e kushteve për shërbime cilësore.

Në Shqipëri, projekti "Shërbimet me bazë komunitare për fëmijët me aftësi të kufizuara" ka synuar ofrimin e mundësive për rehabilitim dhe integrim për fëmijët me aftësi të kufizuara, përmes diagnostikimit të hershëm, trajtimit individual cilësor, si dhe shërbimeve mbështetëse për prindërit e fëmijëve.

Objektivat kryesore të projektit janë:

- Ofrimi i shërbimeve cilësore, me bazë komunitare, shërbime multidisiplinare për rehabilitimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara për të arritur përfshirjen e tyre në shkollë dhe jetën në komunitet;

- Mbështetja e familjeve për të përballuar situatën dhe për të mundësuar zhvillimin fizik, social dhe emocional dhe për të advokuar për të drejtat e fëmijëve të tyre për arsim, kujdes shëndetësor dhe përfshirje sociale;
- Rritja e kapaciteteve të aktorëve/partnerëve në identifikimin e nevojave të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe familjeve të tyre, në adresimin e këtyre nevojave dhe monitorimin e progresit në këtë drejtim.

Projekti në fjalë është në fazën përmbyllëse. Zbatimi i tij ka filluar që në janar 2016. Monitorimi dhe vlerësimi i projektit është bërë në përputhje me kushtet e përcaktuara në projekt.

Në këtë fazë, është e rëndësishme që përvec të tjerave, të evidentohen disa nga praktikat më të mira të identifikuara gjatë procesit të zbatimit të projektit me qëllim nxitjen/inkurajimin e aktorëve dhe faktorëve rajonalë vendorë në replikimin e këtyre praktikave edhe në qytete e rajone të tjera të vendit.

Synohet gjithashtu të identifikohen dhe përshkruhen faktorët mjedisorë që ndikuan në zbatimin e projektit dhe të bëhen rekomandime praktike për një aplikim sa më të mirë të kësaj eksperience edhe në rajone të tjera të vendit.

Vlerësimi i eksperiencave më të mira nga projekti "Shërbimet me bazë komunitare për fëmijët me aftësi të kufizuara" është realizuar në bashkëpunim me punonjësit e Save the Children në Shqipëri që mbulojnë këtë projekt dhe është fokusuar kryesisht në tre drejtime:

- Ofrimi i shërbimeve direkte për fëmijët me aftësi të kufizuara;
- Mbështetja e familjeve të fëmijëve me aftësi të kufizuara në mënyrë që ata të mund të advokojnë për të drejtat e fëmijëve të tyre;
- Rritja e kapacitetit të autoriteteve përkatëse vendore.

Vlerësimi përpiqet të ofrojë informacion në fushat e mëposhtme:

- Vlerësim i eficences, efikasitetit, qëndrueshmërisë dhe ndikimit që kanë patur shërbimet e ofruara përmes këtij projekti;
- Si e vlerësojnë përfituesit kryesorë: fëmijë, prindër dhe aktorë lokalë ndërhyrjen që ofron projekti në funksion të nevojave të tyre;
- Matjen e ndikimit që ka patur ndërhyrja në funksion të nevojave lokale;
- Identifikimi dhe përmbledhja e pikave të forta dhe të dobta të modeleve të ndërhyrjes dhe të bëjë rekomandime që mund të ndihmojnë në hartimin dhe zbatimin e projekteve që adresojnë nevojat e fëmijëve me aftësi të kufizuara për të aksesuar shërbimet e integruara në qendrat e kujdesit për fëmijë, zhvillimin e aftësive të tyre, praktikimin i pavarësisë dhe gëzimin e përfshirjes;
- Të ekzaminojë se si projekti ka adresuar çështje të ndërthurura si promovimi i të drejtave të njeriut dhe të drejtave të fëmijëve, arsimi gjithëpërfshirës, antidiskriminimi, jodhunës, barazia gjinore dhe rezilienca;
- Identifikimi i mësimeve nga kjo ndërhyrje, rreziqet për qendrat e shërbimeve duke vlerësuar situatën nga këndvështrimi i fëmijëve, prindërve, dhe partnerëve të tjerë në komunitet;
- Identifikimi i faktorëve (ligjorë dhe dokumentave politikë, proceseve, ngjarjeve, komunikimi, mjedisi social/demografik) të cilët ndikojnë ndjeshëm në zbatimin dhe arritjen e rezultateve të dëshiruara nga projekti.

2. METODOLOGJIA

Vlerësimi i projektit "Shërbimet komunitare për fëmijët me aftësi të kufizuara", me synimin e identifikimit të praktikave më të mira në zbatimin e tij, u mbështet në metodën cilësore të kërkimit. Metoda cilësore e kërkimit mundëson analizën e thellë të situatës lidhur me cilësinë e shërbimeve të ofruara për FAK, sistemin e mbështetjes së prindërve të fëmijëve me aftësi të kufizuara, rolin e komunitetit dhe të partnerëve të tjerë lokalë për të kontribuar në përfshirjen e fëmijëve në rrjedhat normale të jetës. Kjo metodë kërkimi mundëson identifikimin e praktikave më të mira si dhe sfidave dhe vështirësi në zbatimin e projektit "Shërbimet me bazë komunitare për fëmijët me aftësi të kufizuara".

2.1. Pjesëmarrësit në studim

Pjesëmarrës në studim ishin përfaqësues të qeverisjes qendrore, përgjegjës për hartimin e politikave dhe programeve në fushën e PAK; përfaqësues të institucioneve të qeverisjes vendore që janë të përfshirë në shërbimin dhe përkujdesjen ndaj PAK (Drejtoria e shërbimit social në bashkitë përkatëse, Drejtoria e shërbimit shëndetësor rajonal, DSHP, DAR), drejtues të Save the Children, përfaqësues të organizatës lokale - partnere në projekt, që lobon, promovon dhe advokon për të drejtat e FAK - profesionistë të fushës, psikologë, mësues/mësues ndihmës, specialistë të trajtimit të PAK, prindër, motra/vëllezër të FAK.

Tabela: Pjesëmarrësit në studim

	Niveli qendror	Save the Children	Organizata partnere	Bashkia Durrës	Bashkia Vlorë	Qendra komunitare
Personeli i përfshirë në Projektin për Qendrat e shërbimeve me bazë komunitare për FAK		Drejtoresha Projekti - 2 persona	Ndihmoni jetën-2 persona			Qendra Durrës- 7 persona Qendra Vlorë- 7 persona
Shërbime sociale	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale-1 person			Drejtoresha e shërbimit social	Drejtoresha e shërbimit social	
Shërbimet shëndetësore				Drejtoria rajonale e shërbimit shëndetësor	DSHP (drejtoria e shëndetit publik)	
Arsimi				Drejtoresha e DAR		
Psikologët e shkollave				Fokus grup-7 persona	Fokus grup – 7 persona	
Prindërit				Fokus grup-5 perosna	Fokus grup 7 persona	
Mësues/ mësues ndihmës				Fokus grup -4 persona	Fokus grup 7 persona	

2.2. Instrumentat për mbledhjen e të dhënave

Pjesë e metodologjisë së kërkimit ka qenë edhe *shfletimi i literaturës në këtë fushë*. Studime, raporte, vlerësime, dokumenta ligjorë dhe politikë, praktika dhe modele pozitive nga vende të tjera, standartet e shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara si dhe materiale të tjera burimore që lidhen me fushën e studimit, janë shfrytëzuar për të mundësuar kornizën teorike të vlerësimit.

Një pjesë e rëndësishme e studimit janë edhe instrumentat e përdorura për realizimin e studimit.

Intervistat gjysëm të strukturuara me përfaqësues të qeverisë qendrore, drejtues të programit në Save the Children, drejtues të shoqatës partnere Ndihmoni Jetën, përfaqësues të bashkive (Vlorë dhe Durrës), drejtues të shërbimit social dhe shëndetësor në këto qytete, drejtues të drejtorive arsimore ishin burim infomacioni lidhur me politikat dhe praktikat më të mira në zbatimin e këtij projekti.

Fokus grupet me prindër dhe motra e vëllezër të fëmijëve me aftësi të kufizuar, mësues dhe mësues ndihmës të fëmijëve me aftësi të kufizuar, psikologët dhe punonjësit socialë në shkolla, ndihmuan gjithashtu për të identifikuar edhe vështirësitë, sfidat me të cilat ky projekt është ballafaquar në procesin e zbatimit të tij.

Observimet direkte të vlerësueses shërbyen për të kuptuar atmosferën e punës dhe ndërveprimin midis aktorëve të ndryshëm në jetën e përditshme.

2.3. Analiza e të dhënave

Gjatë intervistimit të aktorëve të sipërpërmendur, por edhe gjatë fokus grupeve u mbajtën shënime me dorë mbi problematikat e përmendura në proces. Më pas, intervistat u transkriptuan dhe u printuan me qëllim lehtësimin e proceseve të kodimit dhe të analizimit. Pai u lexuan dhe rilexuan materialet, u bë kodimi manual i të dhënave, u identifikuan një sërë kodesh nëpërmjet krahsimit konstant. Kodet më të përsëritura u grupuan në kode të reja. Analiza vazhdoi me kombinimin e kodeve dhe vlerësimin e marrëdhënieve ndërmjet tyre.

3. RISHIKIMI I LITERATURËS

3.1. Baza ligjore

Shqipëria ka ratifikuar dy nga konventat më të rëndësishme që përcaktojnë të drejtat e fëmijëve më aftësi të kufizuara, Konventën e të Drejtave të Fëmijëve dhe Konventën e Personave me Aftësi të Kufizuara. Të dyja këto konventa theksojnë detyrimet e shteteve palë për të siguruar që fëmijët me aftësi të siguruara të gëzojnë të drejtat e tyre pa asnjë lloj diskriminimi siç janë e drejta për arsimim, e drejta për kujdes shëndetësor, përfshirje sociale dhe mbrojtje nga dhuna, abuzimi dhe neglizhimi.

Ndërkohë në vitet e fundit Shqipëria ka shënuar progres në përmirësimin e legjislacionit vendas në përputhje me angazhimet ndërkombëtare. E megjithatë, strukturat ekzistuese dhe burimet në vend nuk ju përgjigjen dot këtyre angazhimeve ligjore dhe situata mbetet ende problematike.

Në këtë kontekst, vlen të përmenden disa prej këtyre dokumentave të rëndësishëm ndërkombëtare dhe vendase.

3.1.1. Dokumenta ndërkombëtare

Konventa për të Drejtat e Fëmijëve (KDF)

Kur u miratua Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, shumë personalitete ishin të ndërgjegjshëm se në të përshiheshin edhe të drejtat e fëmijëve, por kishte të tjerë që vazhduan fushatën sensibilizuese për të pasur një dokument të veçantë që do të mbështeste të drejtat e qënieve më të brishta dhe më të pambrojtura.

Në 1959, OKB përshtati një deklaratë për të drejtat e fëmijëve.

Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës, miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara më 20 nëntor 1989, është një nga aktet më të rëndësishme të së drejtës ndërkombëtare në të cilën janë parashikuar të drejtat dhe detyrimet në të gjitha fushat e jetës së fëmijës, të organizuara në një mënyrë kaq të plotë dhe të detajuar si në asnjë akt tjetër juridik në fushën e të drejtave të fëmijëve.

Konventa për të Drejtat e Fëmijës u ratifikua nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë në Shkurt 1992 dhe hyri në fuqi në Mars 1992. Kjo konventë është ratifikuar nga 191 vende të botës duke e bërë atë traktatin e të drejtave të njeriut më të ratifikuar në histori.

KDF parashikon 4 fusha kryesore të të drejtave të fëmijës:

Të drejtat për mbijetesë, të drejtat për zhvillim, të drejtat për t'u mbrojtur, dhe të drejtat për pjesëmarrje.

Në këtë konventë parashikohen të drejtat e fëmijëve si më poshtë:

- E drejta për afeksion, dashuri dhe të kuptuar;
- E drejta për ushqim të përshtatshëm dhe kujdes mjekësor;
- E drejta për arsimim të lirë;
- E drejta për shanse të plota për lojë dhe argëtim;

- E drejta për një emër dhe kombësinë;
- E drejta për kujdes të veçantë në rastet e të qenit me aftësi të kufizuara;
- E drejta për të qenë ndër të parët që merr ndihmë në rastet e fatkeqësive;
- E drejta për të qenë një anëtar i dobishëm i shoqërisë dhe për të zhvilluar aftësitë individuale;
- E drejta për t'u edukuar në frymën e paqes dhe të vëllazërisë universale;
- E drejta për t'i gëzuar këto të drejta pavarësisht nga raca, ngjyra, seksi, feja, kombësia ose origjina shoqërore.

Konventa e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara (KDPAK) (OKB 13 Dhjetor 2006) u miratua nga Shqipëria në vitin 2012. KDPAK përfaqëson nivelin më të lartë të mbrojtjes së të drejtave të personave me aftësi të kufizuara.

KDPAK ka si qëllim mbrojtjen e të drejtave civile, kulturore, ekonomike, politike dhe sociale të personave me aftësi të kufizuara. KDPAK i detyron shtet palë në Konventë të marrin masa për të shmangur diskriminimin dhe për të promovuar përfshirjen dhe barazinë e personave me aftësi të kufizuara. Konventa identifikon fushat ku shtetet palë duhet të zhvillohen në mënyrë progresive me kalimin e kohës me qëllim përmirësimin e standarteve të jetesës dhe të drejtave të personave me aftësi të kufizuara. Për pasojë, Shqipëria përballet me detyrimin e zbatimit të KDPAK, si edhe me monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të saj.

3.1.2. Dokumenta strategjik vendor

Gjatë viteve të fundit, në vend janë hartuar një sërë ligjesh dhe politikash, lidhur me promovimin dhe mbrojtjen e personave me aftësi të kufizuara si Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara, 2016 -2020[6], Ligji për arsimin para universitar (2012), Strategjia e Mbrojtjes Sociale (2015-2020)[7], Dokumenti Politik për Përfshirjen Sociale (DPPS 2016-2020)[8], Ligji për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë (2014)[9], Ligji për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë (2016)[10]. Të gjithë këto dokumente, në masën që trajtojnë çështje të lidhura me personat me aftësi të kufizuara, kanë në themel të tyre vënien në jetë të orientimeve të dhëna në Konventën e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara, të ratifikuar në Dhjetor 2012, nga Qeveria Shqiptare.

Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara, 2016-2020, ka si qëllim të nxisë përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në shoqërinë shqiptare, të parandalojë diskriminimin dhe të eleminojë pengesat për të pasur akses në shërbimet publike dhe realizimin e të drejtave të tyre.

Ligji për Arsimin Para-Universitar (2012), përcakton parime që udhëzojnë arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara, konkretisht për zhvillimin e potencialit të tyre fizik dhe intelektual, përmirësimin e cilësisë së jetës dhe sigurimin e integrimit të tyre të plotë në shoqëri dhe në tregun e punës. Ligji promovon konceptin e arsimit gjithëpërfshirës, duke theksuar se përfshirja në institucione arsimore të specializuara është e përkohshme dhe se përfshirja në kopshte dhe shkolla të përgjithshme ka rëndësi primare.

Strategjia e Mbrojtjes Sociale, 2015-2020, adreson çështjet në lidhje me (i) skemën e ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar, (ii) shërbimet e kujdesit shoqëror ekzistuese dhe ato të propozuara dhe (iii) çdo çështje tjetër në fushën e mbrojtjes sociale.

---

6. VKM nr.483, datë 29 qershor 2016, *"Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të kufizuara, 2016-2020"*.
7. VKM Nr. 1071, datë 23.12. 2015, *"Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të të Mbrojtjes Sociale, 2015-2010"*.
8. Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 87, datë 3.2.2016," Për miratimin e Dokumentit Politik të Përfshirjes Sociale 2016-2020".
9. Ligji nr. 93/2014 datë 28.07.2014, *"Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara"*.
10. Ligji Nr.121, datë 21.11.2016, *"Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë"*

Strategjia reflekton angazhimet e Qeverisë Shqiptare në fushën e Mbrojtjes Sociale duke synuar që t'i sigurojë çdo qytetari shqiptar pavarësisht të ardhurave, origjinës, moshës, gjinisë, etnisë, edukimit, orientimit seksual, identitetit kulturor, bindjeve politike e fetare, shërbime publike cilësore.

Dokumenti Politik për Përfshirjen Sociale (DPPS, 2016-2020), garanton një sistem për monitorimin dhe matjen e përfshirjes sociale në fushat e politikave, si ulja e varfërisë dhe mbrojtja sociale, punësimi dhe aftësimi, arsimimi dhe trajnimi, shëndetësia, nevojat bazë, pjesëmarrja dhe të drejtat e njeriut. Ai nxit transparencën dhe llogaridhënien për mënyrën sesi matet dhe si përdoret përfshirja sociale për të dhënë informacione për zbatimin e shërbimeve publike.

Ligji për Përfshirjen dhe Aksesueshmënrinë e Personave me Aftësi të Kufizuara (2014) përcakton shërbimet e nevojshme për të nxitur jetesën e pavarur, duke përfshirë ndihmën personale, pajisjet dhe mjetet teknike mbështetëse, shërbimet e aksesibilitetit, duke përfshirë transportin, përshtatjen e arsyeshme, dhe, kur është e nevojshme, mbështetjen në vendimmarrje.

Ligji për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara garanton të drejtën për jetesë të pavarur, duke përfshirë edhe aksesin në punësim.

Ligji për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë (2016) thekson se shërbimet shoqërore administrohen në bazë të parimeve universale në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe në mënyrë të veçantë në bazë të këtyre parimeve themelore:

a) Parimi i universalitetit; b) Parimi i drejtësisë sociale; c) Parimi i subsidiaritetit; ç) Parimi i mbështetjes shoqërore; d) Parimi i deinstitucionalizimit; dh) Parimi i partneritetit; e) Parimi i respektimit të të drejtave të njeriut dhe integritetit të përfituesit; ë) Parimi i mosdiskriminimit; f) Parimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale.

3.2. Modelet e përkujdesit për fëmijët me aftësi të kufizuara

Fëmijët me aftësi të kufizuara kanë të drejtën për të qenë të sigurtë, për të marrë shërbime dhe mbështetje me cilësi të lartë dhe të përqëndruar tek individi, dhe të kenë akses në shërbime për të cilat ata kanë nevojë për të rritur pavarësinë dhe zgjedhjen, dhe për të bërë të mundur që ata të kenë një jetë të përmbushur. Kjo e drejtë bazë është themelore për mirëqënien dhe zhvillimin e tyre.

KDPAK njeh të drejtën e fëmijëve me aftësi të kufizuara për të jetuar në familje, në komunitet, të përkrahur me mbështjetje dhe shërbime të nevojshme për ta bërë këtë të mundur. Ajo kërkon që shtetet palë të bëjnë çdo përpjekje për të garantuar se kur një familje nuk mund të kujdeset për një fëmijë me aftësi të kufizuara, kujdesi aternativ mund të jetë një zgjidhje për fëmijën.

Po cilat janë format e kujdesit alternativ për fëmijët me aftësi të kufizuara?

Kujdesi alternativ në institucionet rezidenciale të përkujdesit social është njëra prej tyre. Ka shumë vende sot në botë që mbas diagnostikimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara i kështillojnë prindërit t'i vendosin fëmijët e tyre në institucione rezidenciale, të cilat në shumicën e rasteve janë institucione publike. Eksperienca botërore ka treguar se zhvillimi i fëmijëve në institucionet rezidenciale përballet me problematika të mprehta që cënojnë rëndë zhvillimin e tyre.

Funksionimi i institucioneve rezidenciale të përkujdesit social mbështetet në standarte specifike të shërbimeve dhe kërkon një personel profesional, që udhëhiqet nga vlera dhe norma të larta njerëzore, që respektojnë jetën, personalitetin dhe dinjitetin njerëzor.

Kujdesi alternativ me bazë familjen, është një formë tjetër e përkujdesit për fëmijët me aftësi të kufizuara. Ky model mbështetet tek modeli i familjes - institucionet rezidenciale organizohen si një familje (modeli i Fshatit SOS). Fëmijëve me aftësi të kufizuara ju ofrohen mundësi si në një familje,

një vend që mbështet zhvillimin e tyre personal dhe respekton privatësinë e tyre. Brenda institucionit fëmijët me aftësi të kufizuara kanë mundësi për marrëdhënie intensive, të afërta dhe të ngrohta që i përgatisin ata për jetën jashtë institucionit.

Kujdesi alternative me bazë familjen mund të realizohet edhe përmes **familjeve kujdestare**, të cilat marrin përsipër kujdesin ndaj fëmijës me aftësi të kufizuara për një periudhë relativisht të shkurtër, nga disa javë deri në disa vjet.

Ideja e familjes kujdestare është bërë pjesë e praktikës së kujdesit alternativ për të plotësuar rolin e familjes, kur familja bilologjike e ka të pamundur kujdesin ndaj fëmijës me aftësi të kufizuara, ose kur familja biologjike ka nevojë për një shkëputje/pushim dhe për këtë arësye mbështetet nga familja kujdestare.

Edhe në këtë rast përzgjedhja e familjes, trajnimi, monitorimi, mbështetja dhe orientimi i tyre është pjesë e rëndësishme e procedurave që lehtësojnë dhe mundësojnë kujdesin alternativ për fëmijët me aftësi të kufizuara.

Në kuadrin e shërbimeve për fëmijët me aftësi të kufizuara shumë vende praktikojnë **qendrat ditore**, ku fëmijët marrin shërbime por edhe angazhohen në aktivitete të ndryshme në funksion të përmirësimit të cilësisë së jetës. Përgjithësisht këto janë shërbime që mbështeten nga organizata të shoqërisë civile si dhe donatorë të huaj dhe vendas.

Qendrat për shërbime me bazë komunitare për fëmijët me aftësi të kufizuara janë modeli më i avancuar i shërbimit për FAK. Qendrat janë të vendosura në qendër të komunitetit dhe ofrojnë trajtime dhe shërbime jo vetëm për fëmijët por edhe për prindërit, motrat dhe vëllezërit e FAK, komunitetin, profesionistët, strukturat e qeverisjes vendore. Të tilla qendra janë investime të qeverisjes vendore në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile dhe donatorë lokalë e rajonalë.

Shërbimi në shtëpi është një formë tjetër e shërbimit për fëmijët me aftësi të kufizuara. Në shumicën e rasteve këtë shërbim e mbulon qeverisja vendore përmes specialistëve të trajnuar si punonjës socialë, mjekë, psikologë etj. Një shërbim i tillë përmbledh:

- Ndihmën dhe mbështetjen për të gatuar, pastruar etj duke përmbushur nevojat bazë;
- Ndihmë dhe mbështetje për komunikim, për t'u lidhur me njerëz të afërm apo për të mundësuar shfrytëzimin e bibliotekave, librarive etj;
- Ndihmë për t'u bërë pjesë e aktiviteteve argëtuese;
- Ndihmë për ta bërë shtëpinë më të aksesueshme dhe të përshtatshme për situatën e personit;
- Ndihmë për të mundësuar trajtimin mjekësor;
- Ndihmë për të mundësuar trajtime të vazhdueshme terapeutike, etj.

Shërbimet ndërgjegjësuese, lobuese dhe advokuese janë shërbime të cilat synojnë ndërgjegjësimin e komunitetit, të politikëbërësve dhe vendimmarrësve, si dhe aktorëve të tjerë në këtë fushë për nevojat e komunitetit të personave me aftësi të kufizuara (përfshirë edhe fëmijët me aftësi të kufizuara), lobimin për të drejtat e PAK dhe advokimin për plotësimin e këtyre të drejtave.

Shërbimet për përfshirjen sociale nënkuptojnë të gjitha shërbimet mbështetëse si trajnim profesional, mbështetja me grante dhe punësimi i tyre me qëllim sigurimin e një jete të pavarur dhe më cilësore.

Arsimi gjithëpërfshirës është komponent i rëndësishëm i mbështetjes për fëmijët me aftësi të kufizuara për të përmbushur të drejtën e tyre për arsimin pa diskriminim dhe pa dallim.

4. PREZANTIMI I GJETJEVE SIPAS FUSHAVE TË INTERESIT - REZULTATE DHE DISKUTIME

Në këtë pjesë të analizës do të ndalemi tek gjetjet e analizës dhe prezantimin e tyre sipas objektivave të studimit.

4.1. Praktika të mira në aspektin politik dhe ligjor

Ligji për decentralizimin e shërbimeve sociale si dhe Ligji për shërbimet e përkujdesit social në Republikën e Shqipërisë synojnë ofrimin e shërbimeve për grupet më të rrezikuara të shoqërisë dhe bërjen e tyre sa më të aksesueshme për këto grupe.

Ndryshe nga sa pritej, procesi i decentralizimit të shërbimneve sociale ka krijuar një vakum ose pasiguri në shërbime pasi qeverisja vendore ende nuk është e përgatitur të marrë përsipër sigurimin e shërbimeve sociale sipas nevojave të komuniteteve që mbulojnë. Aq më pak t'i bëjë ato prioritet të aktivitetit dhe punës së tyre të përditshme.

Aktualisht ndjehet një mangësi në shërbime për PAK dhe për FAK. Sic edhe kemi përmendur në hyrje të kësaj analize vetëm 7.8% e FAK marrin shërbime në formën e shërbimit residencial apo të qendrave ditore për ta. Për më tepër, këto shërbime janë të përqëndruara kryesisht në qendrat kryesore urbane. FAK që jetojnë në qendrat e vogla urbane apo në zonat rurale dhe të thella rurale janë të rrezikuar të mos marrin asnjë lloj shërbimi dhe të mbeten jashtë rrjedhës së jetës normale.

Po çfarë sjell projekti "Qendra për shëbime me bazë komunitare për fëmijët me aftësi të kufizuara" në këtë aspekt?

Ky projekt përbën një risi. Ai sjell një eksperiencë të re ku Save the Children dhe organizata lokale 'Ndihmoni Jetën' ngrejnë një shërbim të domosdoshëm për FAK në dy qytete, përkatësisht Durrës dhe Vlorë, të identifikuar nga një studim paraprak si dy qytete me nevoja të konsiderueshme për trajtimin e FAK.

Në fazën e parë të projektit, bashkitë marrin përsipër të vënë në dispozicion mjediset fizike për ngritjen e qendrave ndërsa Save the Children merr përsipër rehabilitimin e ndërtesave, pajisjen e tyre me bazën e nevojshme materiale, përzgjedhjen dhe trajnimin e personelit.

Bashkitë dhe Save the Children kanë firmosur një marrëveshje bashkëpunimi që kërkon nga bashkitë marrjen përsipër të mbështetjes së shërbimit pas përfundimit të projektit në fjalë.

Bashkitë përgatiten gradualisht të marrin përsipër ofrimin e shërbimeve me bazë komunitare për FAK si një nga komponentët e rëndësishëm të përmbushjes së detyrimeve të tyre në fushën sociale.

Drejtoresha e Save the Children, znj. Anila Meco, duke e vlerësuar shërbimin në aspektin ligjor dhe politik, do të theksonte:

> *"Projekti "Shërbimet me bazë komunitare për fëmijët me aftësi të kufizuara" vjen pas një eksperiencë disa vjeçare të Save the Children në Shqipëri në fushën e aftësisë së kufizuar.*
>
> *Megjithëse kanë ndodhur ndryshime të qenësishme në fushën ligjore për fëmijët dhe aftësinë e kufizuar (Ligji për mbrojtjen e fëmijëve, Ligji për mbrojtjen sociale), duket se nevoja për shërbime mbetet e njëjtë.*
>
> *Është e vërtetë se dokumentat ligjorë kanë përjetuar përmirësime të ndjeshme konceptuale, por zbatimi i tyre është ende larg pritshmërive që shoqëria ka. Kjo edhe për faktin se zbatimi i ligjit është edhe çështje kulture. Nga ana tjetër, kalimi nga njëri ligj tek tjetri ka krijuar shpeshherë vakume ligjore që pengojnë zbatimin e tyre.*
>
> *Fusha e aftësisë së kufizuar është një fushë e vështirë dhe e kushtueshme. Burimet financiare të kufizuara në vend e kanë vështirësuar edhe më tej çështjen e mbrojtjes dhe respektimit të të drejtave të personave me aftësi të kufizuar, veçmas të fëmijëve me aftësi të kufizuar.*
>
> *'Fondi social' i krijuar për të mbështetur shërbimet për grupet në vështirësi, është ende i vogël krahasuar me nevojat. Vlerësimet që Save the Children i kishte bërë nevojave në vend kishin evidentuar mungesën e kapaciteteve profesionale në institucionet publike për të ofruar shërbime për fëmijët me aftësi të kufizuara.*
>
> *Për herë të parë Save the Children vendos marrëdhënie kontraktuale ligjore me njësitë e qeverisjes vendore për vazhdimësinë e shërbimeve. Lidhja e kontratave ligjore është bërë mbi bazë të përcaktimit të qartë të detyrimve që palët kanë përkundrejt shërbimit që kërkohet të ofrohet.*
>
> *Bashkitë e përzgjedhura për t'u bërë pjesë e projektit që në fazën fillestare janë përzgjedhur mbi bazë të konkurencës.*
>
> *Bashkitë e Durrësit dhe Vlorës janë përzgjedhur jo vetëm si dy njësi vendore me numër të lartë fëmijësh me aftësi të kufizuar[11], por edhe mbi bazë të vlerësimit të kapacitetit të tyre për t'u angazhur në një shërbim të tillë si dhe të mundësive financiare për të investuar në vazhdimësinë e projektit".*

Projekti 'Shërbimet me bazë komunitare për fëmijët me aftësi të kufizuara' në bashkitë Durrës dhe Vlorë ka inkurajuar ngritjen e qendrave të shërbimit për FAK dhe mbështetjen e tyre nga këto bashki në zbatim të ligjit për qeverisjen vendore, ligjin për decentralizimin e shërbimeve sociale, ligjin për shërbimet sociale në Republikën e Shqipërisë.

Bashkitë mund të mos kenë qenë gati në momentin e parë të ofrojnë këto shërbime, sic edhe ndodh me shumicën e bashkive të tjera, por përgatiten gradualisht për të marrë këtë përgjegjësi që ju ngarkon ligji.

Nga ana tjetër, bashkitë ju përgjigjen më mirë nevojave të komuniteteve të tyre, kryesisht nevojave që kanë të bëjnë me FAK dhe përfshirjen e tyre në sistemin arsimor si një angazhim ligjor dhe politik të qeverisë qendrore.

4.2. Praktika të mira në funksion të qëndrueshmërisë së shërbimit

Për shumë nga fëmijët me aftësi të kufizuara, shpesh është e vështirë ose e pamundur të sigurojnë akses tek shërbimet shëndetësore, edukimi, shërbimet rehabilituese dhe mbrojtëse, ndonëse këto shërbime janë jetike për ta.

---

11. Analiza e situatës së shërbimeve për fëmijët me aftësi të kufizuara në Shqipëri, Save the Children, Tiranë, 2016, fq 12.

Në mënyrë që shërbimet për fëmijët me aftësi të kufizuara të jenë të suksesshme duhet që së pari ato të jenë të ideuara si shërbime holistike, gjithëpërfshirëse, të integruara mes tyre. Në vend ka disa qendra shërbimesh për fëmijët me aftësi të kufizuara të cilat përpiqen të aplikojnë perspektivën holistike të shërbimit. Këto shërbime ofrohen kryesisht nga organizatat joqeveritare, të cilat në shumë raste nuk njihen nga srtukturat e qeverisjes vendore si ofrues të shërbimeve sociale, dhe si të tilla, ju mohohet financimi nga fondet publike për mbështetjen e shërbimeve të ofruara prej tyre. Si rezultat i sa më sipër, shërbimet për fëmijët me aftësi të kufizuara në vend varen shumë nga donacionet dhe pagesat për këto shërbime. Për këtë arësye, cilësia dhe shtrirja e tyre ndryshon nga viti në vit. Kjo situatë jo vetëm minimizon mundësitë për qëndrueshmërinë e shërbimeve, por ajo ul ndjeshëm edhe pritshmëritë e fëmijëve për t'i aksesuar këto shërbime, duke lënë mënjanë cilësinë dhe natyrën gjithëpërfshirëse të shërbimeve.

Kjo është arësyeja që zgjidhje të reja për shërbime të qëndrueshme dhe holistike ishin nevojë imediate në vend, për të mundësuar gërshetimin midis sektorit qeveritar dhe joqeveritar, duke shkrirë në një të vetme burimet financiare, dijet dhe eksperiencat ekzistuese.

Me këtë ide, Save the Children në Shqipëri u angazhua në një partneritet 3 vjeçar me organizatën lokale Ndihmoni Jetën dhe bashkitë e Vlorës dhe Durrësit.

Iniciativa në fjalë parashikonte ngritjen e dy qendrave për shërbime cilësore për fëmijët, qendra model që ofrojnë mundësi rehabilitimin dhe integrimin social të fëmijëve me aftësi të kufizuara, përmes identifikimit të hershëm, rehabilitimit individual, orientimit holistic, dhe shërbimeve mbështetëse për familjarët. Vlora dhe Durrësi u përzgjodhën si dy qendra me numrin më të lartë të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe me numrin më të vogël të shërbimeve rehabilituese.

Save the Children, Ndihmoni Jetën dhe bashkitë e Vlorës e Durrësit firmosën një Memorandum të Bashkëpunimit, duke përcaktuar qartë detyrat dhe përgjegjësitë e secilit prej tre partnerëve. Pjesa më e rëndësishme e memorandumit është pikërisht parashikimi i procesit gradual të kalimit të qendrave nën juridiksionin e bashkisë, që do të thotë se pas përfundimit të projektit, bashkitë do të marrin përsipër financimin e plotë dhe mbajtjen në funksion të qendrave.

> *"Ne kemi detyrimin t'i mbajmë këto shërbime në funksion pas vitit 2018,* - thotë Meme Xhaferaj, drejtore e shërbimit social në Bashkinë e Durrësit.

Në muajt e parë të zbatimit të këtij projekti bashkitë kanë ofruar mjediset fizike për të dy qendrat ndërsa Save the Children mori përsipër rinovimin dhe pajisjen e tyre me mjetet e nevojshme për aktivitetin e tyre.

Roli i organizatës Ndihmoni Jetën ishte kryesisht i lidhur me kujdesin për ta aplikuar modelin holistik të punës me fëmijët me aftësi të kufizuara në mënyrën më të mirë të mundshme, mbështetur edhe në eksperiencën e tyre disa vjecare. Ndihmoni Jetën u angazhua edhe në monitorimin e funksionimit të qendrave deri në kalimin e tyre nën varësinë e bashkive përkatëse.

Përvec kryetarëve të bashkive, Memorandumi i Bashkëpunimit është firmosur edhe nga kryetarët e këshillave bashkiakë, gjë që e bën të vështirë mos zbatimin e tyre. Tashmë, dokumenti ka forcë ligjore dhe çdo problem në zbatimin e tij mund të zgjidhet vetëm përmes proceseve gjyqësore.

Për më tepër, kjo iniciativë është përfshirë në planet e partneritetit strategjik të Save the Children me tre ministritë respektive në Shqipëri: Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Arsimit dhe Sporteve për periudhën 2016-2018. Save the Children ka firmosur Memorandum Bashkëpunimi me të tre këto ministri duke krijuar kështu kornizën e bashkëpunimit ndërsektorial e cila është jetike për mbështetjen gjithëpërfshirëse, rehabilitimin dhe integrimin social të fëmijëve me aftësi të kufizuara në Shqipëri.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MIRËQENIES
SOCIALE DHE RINISË

Nr. 5991 Prot. Tiranë, më 14 . 10 .2016

Nr. 10001/238 prot

Lënda: Mbështetje për projektin "Shërbime me bazë komunitare për fëmijët me aftësi të kufizuara".

Drejtuar : Znj. Anila Meço
Drejtore , Save the Children

TIRANË

E nderuar Znj. Meço

Më lejoni që në emër të institucionit që unë drejtoj, t'ju shpreh mbështetjen për projektin "Shërbime me bazë komunitare për fëmijët me aftësi të kufizuara", i cili synon ngritjen e dy qendrave me bazë komunitare në Durrës dhe në Vlorë që do të ofrojnë shërbime cilësore për fëmijët me aftësi të kufizuar, duke ofruar mundësi për rehabilitim dhe riintegrim, ndërhyrje në fazë të hershme dhe trajtim individual për fëmijët me aftësi të kufizuar si dhe mbështetje holistike për familjet e tyre.

Kjo është një iniciative humane përmes projektit që keni marrë përsipër të realizoni, duke siguruar ngritjen e qendrave në këto dy rajone, me qëllim përmirësimin e aksesit dhe gjithëpërfshirës së fëmijëve me aftësi të kufizuara në kopshte, shkolla dhe komunitet.

Projekti që ju po ndërmerrni është në përputhje me politikat e shtetit Shqiptar dhe Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe me dokumente të rëndësishëm si Strategjia e Mbrojtjes Sociale dhe Planin Kombëtar të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuar , 2016-2020.

Një ndër detyrat dhe angazhimet e Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe të Rinisë është të garantoj përfshirjen dhe aksesueshmërinë e të gjithë personave me aftësi të kufizuara në nivelin maksimal, të parandalojë diskriminimin dhe të eliminojë pengesat për të pasur akses në shërbimet publike dhe realizimin e të drejtave të tyre, duke përmbushur me sukses reformat kryesore që Qeveria aktuale ka marrë përsipër të realizojë.

Më lejoni t'ju shpreh dhe një herë mbështetjen maksimale të Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe të Rinisë dhe stafit që unë drejtoj në realizimin e projektit

Duke Ju falenderuar,

Z. Bledi KLOSI

MINISTER

REPUBLIKA E SHQIPERISE MINISTRIA E MIRËQENIES SOCIALE DHE RINISË TIRANË

"Ngritja dhe funskionimi i këtyre qendrave është një model ekselent për t'u aplikuar edhe në zona të tjera. Kjo praktikë është në përputhje me politikën dhe përpjekjet tona reformuese në mbështetje të përfshirjes së personave me aftësi të kufizuara", thotë Bardhylka Kospiri, zv. Ministre e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, gjatë inagurimit të qendrës në Vlorë.

Komisione të përbashkëta me përfaqësues të Save the Children, Ndihmoni Jetën dhe Drejtorisë së Shërbimeve Sociale në të dy Bashkitë realizuan procesin e përzgjedhjes së stafit dhe punësuan profesionistë, specialistë të mirëtrajnuar.

Pavarësisht eksperiencave të tyre të mëparshme, 14 anëtarët e personelit për të dy qendrat, ju nënshtruan një trajnimi intensiv për fuqizimin e kapaciteteve të tyre profesionale dhe monitorimit profesional, duke u bërë kështu profesionistë të pajisur me dijet bashkëkohore dhe shprehitë për të ofruar shërbime cilësore për fëmijët me aftësi të kufizuara në rajonet e tyre.

Paralelisht me ngritjen e kapaciteteve të personelit të përzgjedhur, Save the Children u angazhua intensivisht në renovimin e mjediseve fizike dhe pajisjen e tyre me mjetet e nevojshme, duke e mbyllur këtë proces në muajin gusht 2016.

Qendrat u hapën zyrtarisht në 22 Tetor dhe 19 Nëntor 2016, dhe që nga ajo kohë ato ju kanë ofruar shërbime 197 fëmijëve dhe 355 pjesëtarëve të familjeve të tyre.

E pra bashkëpunimi i Save the Children me organizatën lokale, firmosja e Memorandumit të Bashkëpunimit me Bashkitë e Vlorës dhe Durrësit si dhe me ministritë e linjës, ndarja e përgjegjësive dhe angazhimi i partnerëve në përmbushjen e detyrimeve që burojnë nga dokumentat ligjorë dhe politikë përmes një procesi fuqizues dhe gradual vlerësohet si një model pozitiv për arritjen e qëndrueshmërisë dhe ruajtjen e cilësisë së shërbimit.

Përfshirja e prindërve për rritjen e kapaciteteve të tyre për të advokuar për të drejtat e fëmijëve duket se ka qenë një sukses tjetër i qendrave. Një grup i përbërë nga prindërit dhe stafi i qendrave, të trajnuar për gjithëpërfshirjen dhe advokasinë lidhur më çështje si transparenca e fondeve publike, efikasiteti dhe eficenca në përdorimin e fondeve publike, analiza e buxhetit për të drejtat e fëmijëve, buxhetimi me pjesëmarrje, kanë filluar të punojnë me pjesëtarë të komunitetit dhe autoritetet lokale për të arritur qëndrueshmërinë e shërbimeve të ngritura tashmë. Task Forca e prindërve në Durrës ja doli të siguronte se bashkia e Durrësit do të mbulojë pagesat e punonjësve të stafit si dhe koston administrative të qendrës për periudhën 2018-2019, kohë kur Save the Children ka parashikuar të fillojë kalimin gradual të qendrës nën juridiksionin e bashkisë. Edhe Task Forca e prindërve në Vlorë është duke punuar intensivisht për të arritur të njëjtën gjë me bashkinë e Vlorës.

4.3. Praktika të mira në aksesimin e shërbimeve me bazë komunitare të fëmijëve me aftësi të kufizuara

Të dhënat nga studime të mëparshme por edhe intervistat me aktorë vendorë theksojnë se shumica e fëmijëve me AK nuk marrin shërbime sipas nevojave të tyre pasi shërbimet nuk ekzistojnë në vendbanimet e tyre, shërbimet janë private dhe për këtë arësye janë të kushtueshme, prindërit e kanë të pamundur të lëvizin nga njëri qytet në një tjetër pasi transporti është gjithashtu i kushtueshëm.

Projekti "Shërbimet me bazë komunitare për fëmijët me aftësi të kufizuara'" krijoi një model tjetër shërbimi për këta fëmijë. Shërbimi ju afrua qendrave të banimit, atje ku janë fëmijët me AK. Shërbimi është falas dhe është i aksesueshëm nga fëmijët e familjeve me probleme ekonomike.

Përfaqësues të shërbimeve sociale në nivel vendor, punonjës të bashkive, punonjës të shërbimit shëndetësor, punonjës të drejtorive arsimore kanë theksuar se shërbimi i qendrave në Durrës dhe Vlorë ka mundësuar mbështjetjen e FAK nga këto qytete me shërbime të specializuara për të mundësuar integrimin e tyre në shkollë dhe në jeten në komunitet.

Rast ilustrues

Nga izolimi në zhvillimin e aftësive sociale dhe mundësive për arsimim

Elkida, një vajzë e ëmbël dhe e bukur 10 vjeçare me Sindromën Down, ka lindur në një nga fshatrat e Pukës, një nga zonat malore më të varfëra të Shqipërisë Veriore, me nivelin më të lartë të vdekshmërisë foshnjore në Shqipëri, një zonë që ende drejtohet nga kodet tradiocionale dhe paragjykimet.

Prindërit e Elkidës, si shumica e popullsisë në Pukë, luftonin për të fituar jetesën dhe për të mbijetuar.

Edhe pse të ngarkuar me varfërinë dhe papunësinë, prindërit ishin shumë të gëzuar dhe ndiheshin të bekuar që do të prisnin beben e tyre të parë në familje. Nëna e Elkidës, vetëm nëntëmbëdhjetë vjeç në atë kohë, lindi në spitalin e Pukës, ku fatkeqësisht nuk kishte asnjë specialist që mund t'i shpjegonte

ose t'i tregonte për shëndetin dhe situatën e Elkidës. Brenda katër vitesh nga lindja e Elkidës, familja u zgjerua edhe me dy vajza të tjera dhe prindërit ndiheshin të lumtur që Elkida do të kishte edhe dy motra të tjera për të luajtur e për t'u rritur sëbashku.

Gjatë viteve të para të jetës Elkida sëmurej shpesh dhe prindërit filluan të vinin re dallime të ndjeshme krahasuar me motrat e saj, por nuk ishin në gjendje të shpjegonin se çfarë ishte ndryshe tek ajo. Ajo nuk ecte dhe kishte probleme të mëdha me të folurit.

Vetëm kur Elkida u bë 4 vjeç, një mjek në Tiranë u tha prindërve se Elkida kishte lindur me Sindromën Down dhe se edhe mund të paralizohej. Ai ju shpjegoi se Elkida nuk do të mund të kishte një jetë normale.

Për shkak të dëshpërimit të thellë dhe mentalitetit, prindërit e mbanin Elkidën në shtëpi shumicën e kohës, të izoluar nga fëmijët e tjerë dhe komuniteti. Elkida shpesh shpërthente në lot e të qara dhe e vetmja gjë që ajo donte të bënte ishte të shihte televizor. Ajo shpesh shpërthente me sjellje agresive dhe e kishte të vështirë të merrte komanda të thjeshta siç mund të ishin larja e duarve të saj apo hapja dhe mbyllja e derës. Elkida ishte shumë e varur nga prindërit e saj të cilët tashmë kishin edhe dy fëmijë të tjerë për të rritur.

Kur Elkida u bë 5 vjeç, prindërit ndiheshin shumë të pashpresë dhe shumë të shqetësuar për zhvillimin dhe të ardhmen e Elkidës. Ata filluan të mendojnë për të lëvizur drejt ndonjë qyteti tjetër ku mund të gjenin më shumë mundësi për familjen dhe përkrahje për zhvillimin dhe arsimimin e fëmijëve të tyre. Për më tepër, atyre u ishte thënë se kishte një shkollë të specializuar për fëmijët me aftësi të kufizura dhe se Elkida mund të rregjistrohej në atë shkollë.

Kështu, ata e ngritën familjen e tyre nga Puka dhe erdhën e u vendosën në Durrës. Ata jetonin me qera në një shtëpi të vogël dhe të varfër në një nga zonat më të varfëra të qytetit ku ka edhe shumë familje të tjera të migruara rishtazi.

Por pas gjashtë muajsh në shkollën për fëmijët me nevoja të veçanta, u bë e qartë se shkolla speciale nuk ishte zgjidhja e problemit për Elkidën dhe prindërit e saj. Ajo kishte nevojë për specialistë që të mund t'i ofronin asaj trajtim individual. Elkida qante vazhdimisht dhe nuk mund të qëndronte më shumë se 5 minuta ulur në bangë.

Mungesa e zhvillimit tek Elkida gërshetuar me koston e lartë të shkollës speciale si dhe problemet e rënda të varfërisë dhe të papunësisë, i detyruan prindërit e Elkidës, Blertën dhe Antonin, të ktheheshin përsëri nga kishin ardhur, drejt Pukës.

Vështirësitë familjare dhe izolimi i Elkidës e rënduan edhe më shumë gjendjen e familjes gjatë dy viteve të rikthimit në Pukë. Ata ndiheshin shumë të dëshpëruar dhe siç shprehet Blerta, nëna e Elkidës, "kisha shumë frikë se nëse do të vazhdonim të jetonim më gjatë në Pukë, unë do ta humbisja përgjithmonë vajzën time".

Kur Elkida u bë 8 vjeç ata u detyruan të provonin edhe njëherë të ktheheshin në Durrës. Për shkak të vështirësive financiare ata nuk kishin zgjidhje tjetër veçse të merrnin me qera të njëjtën banesë. Sapo ata u vendosën atje, ata filluan të kërkonin mundësi dhe mbështetje për vajzën e tyre. Ata u përpoqën ta regjistronin Elkidën në shkollën publike pranë zonës ku ata jetonin, por ata u refuzuan sapo mësuesit mësuan për gjendjen e Elkidës.

Gjatë viti të parë të rikthimit në Durrës, izolimi vazhdoi për Elkidën, por ata ishin gjithsesi më të kënaqur për faktin se babai i Elkidës kishte gjetur një punë si shofer dhe mjekët në Durrës ishin më të kualifikuar dhe përpiqeshin t'ju shpjegonin prindërve situatën e Elkidës lidhur me zhvillimin dhe nevojat e saj.

Në tetor 2016, kur Elkida ishte 9 vjeç, Save the Children hapi në Durrës 'Qendrën e shërbimeve me bazë komunitare për fëmijët me aftësi të kufizuara', një institucion i mirë organizuar me klasa dhe mjedise loje për fëmijët.

Rasit i Elkidës u referua në qendër nga një mjek neuropediatër, pjesë e rrjetit të qendrës. Brenda disa ditësh nga hapja e qendrës, Elkida filloi të merrte pjesë në trajtimin me terapi individuale, pa asnjë detyrim për prindërit e saj. Ndryshimi i Elkidës ishte i menjëhershëm. Elkida filloi të lulëzojë në Qendrën komunitare të Durrësit. Për një kohë të shkurtër ajo filloi në ndërveprojë me specialistët dhe të miqësohej me fëmijët e tjerë në qendër. Për më tepër, specialistët e punës në qendër ishin në gjendje të ndryshonin sjelljen e Elkidës.Ajo ishte mësuar të qante dhe të grindej për të arritur gjërat që donte. Duke injoruar lotët e saj, specialistët e mësuan Elkidën të shprehte nevojat dhe të kryente detyrat dorë pas dore.

Shumë shpejt Elkida filloi të kujdesej për higjenën e saj personale dhe të merrte pjesë në aktivitetet në klasë pa u mërzitur dhe pa thyer objektet. Specialistët u përpoqën dhe ja dolën ta shkëpusnin Elkidën nga varësia totale e prindërve. Kur Elkida mbërrin në qendër, ajo nuk qan më. Ju thotë prindërve 'mirupafshim' për disa orë që ajo do të qëndrojë në qendër për terapi sjelljeje dhe komunikimi.

Elkida mërzitet shumë nëse prindërit nuk e sjellin dot në qendër për disa ditë me radhë. Ajo është shumë e lumtur kur vjen në qendër.

Sot Elkida është një fëmijë krejt tjetër.Ajo është e gjallë, e qeshur dhe simpatike, e gatshme për t'u lidhur me të gjitha zhvillimet e fundit në serialin e saj të preferuar në televizor ose me ngjarjet në romanin që ajo po lexon me një nga terapistet e qendrës. "Është e vështirë të besohet se ky fëmijë i qeshur dhe i dashur, gjithmonë i gatshëm për të marrë ose të japë një përqafim të madh, u diagnostikua dikur si agresive, e shkëputur nga shokët dhe shoqet, kokëforte dhe me një zhvillim të pasigurtë fizik në të ardhmen ", tha punonjësja sociale e qendrës e cila bën vizita të rregullta në shtëpinë e Elkidës për të monitoruar progresin dhe për ta mësuar nënën e Elkidës se si të punojë me vajzën e saj. "Tani, Elkida luan shumë me motrat e saj dhe vëllain e vogël. Ata vazhdimisht ndërveprojnë me njëri-tjetrin. Ata e bëjnë atë të qeshë dhe të luajë me ta. Kam mësuar shumë gjëra të reja gjatë trajnimeve dhe konsultime me specialistët e qendrës. Kam mësuar se çdo fazë e zhvillimit të fëmijës është e rëndësishme dhe nuk duhet të injorohet. Izolimi e përkeqëson zhvillimin e tyre. Ndihem me fat dhe nuk mundem ta shpreh mirënjohjen time të mjaftueshme për punën e jashtëzakonshme të specialistëve të qendrës. Qendra e ka ndryshuar jetën e vajzës time përgjithmonë ", tha nëna me sytë e mbushur me lot.

Qendra për shërbime me bazë komunitare për FAK në Durrës është e fokusuar në punën me fëmijët me synimin e përfshirjes së tyre në sistemin arsimor. Një arritje e rëndësishme në punën me Elkidën do të jetë këtë shtator kur Elkida do të regjistrohet dhe ndjekë shkollën publike në zonën ku ajo banon. Elkida ndërkohë ka bërë përparime të ndjeshme në aftësitë e saj për të shkruar e lexuar.

"Ajo ka ndryshuar shumë që nga koha kur ajo filloi të frekuentonte qendrën dhe kur ajo zemërohej jashtëzakonisht shumë dhe shumë shpejt. Elkida tani i njeh mirë shkronjat dhe numrat, të cilat do ta bëjnë më të lehtë ndjekjen e shkollës prej saj", thotë nëna e Elkidës plot optimizëm.

Transformimi i Elkidës është vetëm një nga rastet e suksesit që vjen nga ekipi i dedikuar e specialistëve që punojnë në qendrën e Durrësit.

Që nga hapja e dyerve të saj, qendra ka qenë e angazhuar në aktivitete për rritjen e ndërgjegjësimit të publikut, organizimin e trajnimeve për prindërit e fëmijëve me AK dhe komunitetin në përgjithësi.

"Puna jonë nuk fillon dhe përfundon me atë që ne arrijnë brenda mureve të qendrës. Duhet të vazhdojmë bashkëpunimin me komunitetin dhe shkollat", thotë menaxherja e qendrës, Alda.

Ndërkohë që Elkida është duke marrë terapinë e saj, na tregon krenarisht një nga vizatimet e saj që varet në murin e qendrës: një peshk i artë, i ngjyrosur në të njëjtën ngjyrë si flokët e saj. Peshku është duke notuar në rrjedhën e sipërme të një lumi të ndritshëm, ngjyrë blu, mes peshqve të tjerë me ngjyra të forta.

Përveç kësaj, ndërsa ajo është në qendër, i pëlqen të luajë me lodra gatimi dhe thotë: "Kur të rritem unë do të gatuaj për vëllezërit e motrat e mia dhe të gjithë fëmijët dhe mësuesit në qendër ". Duket se Elkida, me talentet e saj të fshehura dhe buzëqeshjen e bukur, mbështetjen e familjes së saj dhe specialistëve të qendrës, do të gjejë një vend për veten në vitin e ardhshëm shkollor dhe mundësi më të mira për të realizuar dëshirat e saj, njësoj si bashkëmoshatarët.

Rasti i Elkidës ilustron mungesën dhe njëkohësisht nevojën për shërbime me bazë komunitare për FAK në shumë qytete dhe zona të banuara në vend. Në mungesë të tyre, FAK mbeten të pandihmuar për t'u integruar.

Ngritja e qendrave në Durrës dhe Vlorë tregoi se të tilla qendra janë të domosdoshme aty ku numri i FAK është i lartë, madje, në disa qytete lipset të ketë më shumë se një qendër të tillë.

> *Babi i Geraldit vjen nga Bulqiza. Ka lënë vendlindjen për të qenë më pranë shërbimeve për fëmijën e tij. E ka regjistruar në qendër dhe prej disa muajsh frekuenton rregullisht qendrën ku merr 2 orë fizioterapi. Djali ka patur probleme me ekuilibrin dhe të folurit. Falë ndërhyrjes, ai ka përmirësuar të ecurën dhe ndjehet më mirë.*

Përfaqësuesja e Drejtorisë rajonale të Shërbimit Shendetësor në Durrës do të vinte në dukje:

> *'Mirë do të ishte që qendra të tilla të ngrihen edhe në zona të tjera të bashkisë si Spitalla, Këneta, Plazhi, Shkozeti. Ka shumë FAK në këto zona dhe mungojnë shërbimet'.*

Ndërsa drejtoresha e drejtorisë së shërbimeve sociale në Bashkinë Durrës shton:

> *'Durrësi ka nevoja për shërbime në familje edhe në zona të tjera si Sukth, Rrashbull'.*

E njëjta situatë vihet në dukje edhe nga përfaqësueset e bashkisë së Vlorës. Ato ndihen me fat që një shërbim i tillë është ngritur në qytetin e tyre dhe ju vjen në ndihmë një numri të konsiderueshëm fëmijësh që deri dje nuk merrnin asnjë trajtim. Megjithatë, nevoja për shërbime të tilla më bazë komunitare është e madhe. Ato shprehen se Vlora ka nevojë edhe për qendra të tjera si kjo.

4.4. Praktika të mira në aspektin e cilësisë së shërbimit me bazë komunitare për fëmijët me aftësi të kufizuara

Rast ilustrues

Metoda 'HEART' po ndihmon zhvillimin e vetëvlerësimit të tij dhe aftësive edukative

Një nga fëmijët që përfiton nga shërbimet e qendrës në Durrës është Arjoni, 16 vjeç, i diagnostikuar me paralizë cerebrale spastike që në vitin e tij të parë të jetës.

"Arjoni kishte shumë vështirësi në lëvizje, lojë dhe komunikim. Për një nënë që i thuhet se fëmija juaj nuk do të ecë, nuk do të luajë, nuk do të mësojë dhe nuk do të flasë, është një moment shkatërrues dhe unë nuk mund ta shpjegoj dot çfarë dhimbje dhe sa e pashpresë kam qenë në atë moment dhe shumë herë gjatë këtyre 16 viteve", na tha nëna e Arjonit.

Familja e Arjonit përbëhet nga gjashtë vetë, gjyshi, dy prindër dhe dy vëllezër më të mëdhenj në moshë dhe jetojnë në një nga zonat më të varfra informale të Durrësit. Shumë familje të emigruara nga zonat rurale janë vendosur në këtë zonë gjatë dekadës së fundit.

Babai i Arjonit punon si shofer taksie dhe vëllai më i madh punon në një call center. Vëllai tjetër, që është më i lidhur me Arjonin, është 18 vjeç dhe ndjek arsimin e mesëm. Nëna e Arjonit është e papunë dhe jeta e saj është e përkushtuar për t'u kujdesur për Arjonin dhe gjithë familjen.

Jeta e Arjonit ka qenë me të vërtetë e mbushur me pengesa dhe përpjekje. Gjatë gjithë jetës së tij shërbimet e vetme që ai ka përfituar ka qenë ndihma sociale prej rreth 100 euro në muaj dhe dy javë trajtim rehabilitues në një qendër komunitare në Tiranë. Përveç aftësive të tij të kufizuara për të jetuar një jetë si gjithë bashkëmoshatarët dhe shokët e tjerë të tij, ai sëmuret shpesh dhe vuan nga epilepsia dhe astma. Ai merr vazhdimisht ilaçe. Mungesa e shërbimeve për rehabilitim e kishte përkeqësuar situatën e tij psiko-sociale, veçanërisht të vet-shprehurit dhe komunikimin.

"E ndërsa Arjoni rritej, nevoja për t'u shprehur dhe komunikuar ishte gjithnjë e më e madhe. Për këtë arësye i kisha blerë ngjyra, lapsa, libra për ta inkurajuar dhe për të mundësuar zhvillimin e tij, por gjithshka dukej e kotë. Arjoni hezitonte të përdorte gjithshka dhe sikur nuk donte të mësonte. Ne menduam ta regjistronim në shkollë, por mësuesit refuzuan ta regjistronin për shkak të natyrës së heshtur që ai kishte. Ai qante kur shikonte fëmijët e tjerë që shkonin në shkollë çdo mëngjes. Mua po më plaste zemra. Ai e krahasonte vetem me disa vija të drejta të zeza që ai vetë i vizatonte" – tregon nëna e tij. Familja e tij ishte e shqetësuar dhe kishin frikë se ai mund të kalonte në depresion, prandaj filluan të kërkonin ndihmë.

Familja e tij u referua në Qendrën për shërbime me bazë komunitare për fëmijët me aftësi të kufizuara në Durrës që nga ditët e para të aktivitetit të saj. "Fillimisht ishim disi skeptikë, megjithëse shumë të lumtur që kishim një qendër shërbimi dhe afër zonës sonë të banimit. Atmosfera dukej shumë mirëpritëse dhe stafi dukej shumë profesional. Kjo na bëri të merrnim vendimin që bashkë me Arjoni të vinim në qendër", thotë nëna e Arjonit.

'Që nga ajo kohë unë dhe Arjoni nuk mungojnë kurrë në qendër. Arjoni shkon i pari dhe ikën i fundit nga qendra. Ai e quan qendrën shkollë dhe është shumë i përkushtuar dhe i lumtur për pjesën e tij të punës në qendër'.

Pas më pak se një viti pune mbështetëse me terapi individuale dhe terapi grupi si dhe me aktivitete intensive në qendër, Arjoni ka bërë përmirësime të ndjeshme në motorikën e madhe, motorikën fine, zhvillimin e tij emocional dhe aftësitë e të nxënëit.

Një nga metodat më të suksesshme të punës të aplikuar me Arjonin dhe me dhjetëra fëmijë të tjerë është metoda me bazë arti-HEART. Kjo terapi, e përshtatur për t'u zbatuar me fëmijët me aftësi

të kufizuara nga ekipi i Save the Children, e ka ndihmuar Arjonin dhe bashkëmoshatarët e tij që frekuentojnë qendrën të zhvillojnë aftësi jetësore dhe të përmirësojnë situatën e tyre psiko-sociale.

Në mars të vitit 2017, stafi i Qendrave të shërbimeve me bazë komunitare u trajnuan intensivisht për konceptet kryesore dhe pjesën praktike të metodës dhe menjëherë pas saj filluan zbatimin e kësaj metode në praktikë. Në të vërtetë, metoda është një nga terapitë më të suksesshme që përdoret nga qendra dhe që i ndihmon fëmijët të shprehin ndjenjat e tyre dhe të vendosin një komunikim jo-verbal me njëri-tjetrin dhe me specialistët e qendrës.

Gjatë aktiviteteve të strukturuara HEART, të cilat përfshijnë elemente të shërimit dhe të të mësuarit, Arjoni pati shansin të zhvillonte aftësi të motorikes fine dhe motorikës së madhe, fitoi zhvillim të aftësive konjitive, përmirësoi ndjeshëm vetëvlerësimin, vetëshprehjen dhe aftësitë e të nxënit.

Sot, ai është në gjendje të godasë dhe hedhë topin tek shokët e tij, të kontrollojë pozicionin e trupit, dhe të ecë më mirë. Nëpërmjet gishtit por edhe nëpërmjet vizatimit normal, nëpërmjet lojrave me puzzle dhe përdorimit të I-Pad ka zhvilluar muskujt e gishtave dhe kujtesën. Ai ka mësuar sesi të kombinojë dhe ndajë ngjyrat, si të porosisë gjërat e dëshiruara bazuar në shkronjat e alfabetit. Ai ka fituar aftësi praktike në organizimin e gjërave, në formësimin dhe riformësimin e objekteve. Aktivitetet kanë zhvilluar aftësitë e tij për të bashkëpunuar, përqëndruar dhe ndjekur udhëzime specifike.

Në bashkëpunim me bashkëmoshatarët e tjerë të qendrës dhe psikologen, Arjoni dhe bashkëmoshatarët e tij kanë qenë në gjendje të ndërtojnë lagjen e tyre ideale dhe të ndjehen krenarë dhe të lumtur për t'ua prezantuar atë prindërve të tyre. Arjoni ishte arkitekti kryesor i veprës së ndërtuar prej tyre. Ai projektoi gjithë idenë në lidhje me ndërtesat, parqet e gjelbëruara, objektet që simbolizonin pjesë të rëndësishme të lagjes së tyre. Ai është gjithashtu në gjendje të shpjegojë nëpërmjet gjesteve dhe veprimeve pjesën e tij të preferuar të artit që është sheshi i gjelbëruar i lojërave.

Harta e trupit është një veprimtari tjetër që atij i pëlqen të angazhohet dhe që krenohet. Ai është në gjendje të vizatojë pjesët e trupit të tij dhe t'i dallojë ato edhe përmes ngjyrave. Përmes pjesëve të trupit ai është në gjendje të shprehë zemërimin dhe lumturinë e tij. Nëpërmjet veprave të artit, nëna mund të kuptojë për herë të parë pas 16 vitesh si ndihet djali, është i zemëruar apo i lumtur.

Ndryshimet e rëndësishme dhe të shpejta psiko-sociale dhe motorike të Arjonit kanë rritur shpresat për një rrugë shumë më të mirë përpara. Tani, Arjoni ka mundësinë për të marrë shërbime cilësore dhe të rehabilitojë aftësi që i kishin munguar gjatë gjithë jetës së tij.

Në qendër, ai ka bërë shokë e miq dhe është krenar për zhvillimin dhe arritjet e tij. Arjoni ka me se të krenohet sot.

Për herë të parë Qendra e shërbimit me bazë komunitare për FAK është konceptuar si një e tërë, si një shërbim shumëdimensional.

Projekti "Shërbimet me bazë komunitare për fëmijët me aftësi të kufizuara" është një risi në fushën e shërbimeve për aftësinë e kufizuar pasi ai synon të koordinojë shërbimet cilësore për fëmijët me shërbimet në shkolla për gjithë përfshirjen, shërbimet për identifikimin e hershëm të aftësisë së kufizuar, shërbimet për prindërit dhe familjarët e tjerë si dhe ndërhyrjen për rritjen e kapaciteteve të njësive të qeverisjes vendore për më shumë vemendje për shtresat në nevojë. Si i tillë, shërbimi i ofruar nga qendrat e ngritura në Durrës dhe Vlorë, është i plotë - thotë drejtoresha e Save the Children.

Shërbimet e qendrës ofrohen në partneritet me një organizatë lokale.

Projekti zbatohet në partneritet edhe me një organizatë lokale (Ndihmoni Jetën) dhe kjo ka bërë që projekti të jetë konkret, në përshtatje me mjedisin shqiptar dhe në përgjigje të nevojave që ka vendi ynë për këtë grup social - thotë një nga drejtueset e programit në Save the Children.

Fëmijët trajtohen nga specialistë të fushës sipas nevojave të tyre.

> *'Shërbimi i ofruar është holistik. Ai mbulon të gjitha nevojat e fëmijëve'* - thotë drejtuesja e Ndihmoni Jetën.

Shërbimet që ju ofron fëmijëve janë të shumëllojshme. Punonjësit e qendrave shpjegojnë se ato ofrojnë disa lloj shërbimesh për fëmijët: Terapi Individuale - Terapi zhvillimi, terapi arti, menaxhim sjelljeje, logopedi, terapi okupacionale, aftësim akademik.

Për disa nga fëmijët (7 prej tyre në qendrën e Durrësit dhe 5 në qendrën e Vlorës) qendra ofron shërbim ditor nga ora 8:00 deri në 12:00.

Ndërkohë, në punën e qendrave përfshihen edhe aktivitete të tjera si:

> *Shërbim për prindërit - këshillim, informim; shërbim për motrat dhe vëllezërit - këshill me grupe të rinjsh, grupe të vetndihmës; aktivitete ndërgjegjësuese për komunitetin; shërbime në familje- për informim dhe ndërgjegjësim; rritje të kapaciteteve të aktorëve lokalë; iniciativa për mbledhjen dhe mbajtjen aktive të rrjetit të partnerëve lokalë* - shpjegojnë punonjësit e të dy qendrave.

Aktualisht të dy qendrat ofrojnë terapinë me bazë artin- HEART, e cila përdoret për të inkurajuar shprehjen e emocioneve dhe zhvillimin e vetvlerësimit tek FAK.

Në të dy qendrat ka filluar aplikimi i programit PORTAGE - ndërhyrja e hershme në familje për identifikimin dhe trajtimin e hershëm të rasteve me AK.

Ndërkohë, pothuajse të gjithë prindërit e intervistuar në grup, mësuesit ndihmës, psikologët e shkollave nënvizojnë nevojën për më shumë orë pune me fëmijët. Një ose dy orë në javë terapi që marrin fëmijët nuk është e mjaftueshme për të bërë ndryshim tek ata. Shtimi i orëve të punës do të thotë mbingarkesë për stafin e qendrave, që edhe kështu, është i mbingarkuar.

Shtimi i personave të specializuar në stafet e qendrave është domosdoshmëri, siç është edhe nevoja për më shumë qendra të tilla në këto qytete, në zonat rurale të bashkive, por edhe në qytete të tjera.



> *Nëna e Elkidit shprehet se janë të kënaqur nga cilësia e punës dhe përgatitja e stafit. Ndërkohë që është e nevojshme shtimi i stafit për të përballuar nevojat e fëmijëve për më shumë orë pune me ta.*

> Drejtoresha e shërbimit social në bashkinë e Durrësit shprehet se: *'Vazhdimësia e shërbimeve të tilla duhet parë edhe me disa përmirësime të mundshme si shtimi i personelit profesionist për më shumë orë pune me fëmijët sipas nevojave, shtim i mjediseve të punës në qendër, shtimi i bazës materiale'.*

4.5. Praktika të mira në funksion të arsimit gjithëpërfshirës

Shërbimi i ofruar në qendrën për shërbime me bazë komunitare për FAK në Durrës dhe Vlorë i ka shërbyer edhe realizimit më të mirë të përfshirjes së FAK në arsimin e detyrueshëm.

> Sic edhe tregojnë mësuesit, mësuesit ndihmës dhe psikologët e shkolllave, '*shpeshherë integrimi i FAK në shkollë mbetej një komponent formal pasi shkolla nuk mundëson një trajtim të mjaftueshëm individual për këta fëmijë. Bashkëpunimi me qendrat komunitare kanë krijuar mundësinë e referimit të FAK në qendër dhe ndërhyrjen me terapi individuale për të përmirësuar aftësitë jetike dhe rritur mundësitë për aftësim akademik. Puna në qendër ka lehtësuar punën në klasë me këta fëmijë, por edhe ka kontribuar në vijim më të mirë të shkollës prej tyre. Disa nga fëmijët, që e kishin braktisur shkollën, i janë rikthyer asaj, paralelisht me punën në qendër*'.

Shërbimi i individualizuar, shërbimi profesional, shërbimi në funksion të ndjekjes së shkollës, fitimi i aftësive më të mira për jetën, përmirësimi i komunikimit, shprehja e emocioneve, kontrolli i zemërimit dhe përmirësimi i sjelljes, kontrolli më i mirë i lëvizjes së trupit dhe përdorimi më i mirë i duarve janë disa nga rezultatet e arritura mes 180 fëmijëve që ndjekin këto dy qendra.

> Një nga psikologet e shkollave tregon se *stafi i qendrave nuk ndalet me punën në qendër. Ato shpesh i gjen në takime me përfaqësuesit e institucioneve vendore për të mundësuar integrimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkollat normale të komunitetit të tyre.*

Praktika e aplikuar nga Save the Children në Shqipëri për të integruar shërbimet shkollë-komunitet, duket se ka shënuar një praktikë shumë pozitive dhe ka ndikuar drejtpërsëdrejti në përfshirjen dhe zhvillimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara. Ajo praktikë erdhi si rezultat i punës së qendrave me komunitetin dhe reflektimit të nevojave konkrete. Praktika e punës së integruar shkollë- komunitet fokuset kryesisht në përmirësimin e rezultateve akademike të fëmijëve me aftësi të kufizuara në nivelin para shkollor dhe shkollën fillore, dhe në aplikimin e shërbimeve që ndihmojnë zhvillimin e fëmijës, pavarësinë dhe përfshirjen sociale.

Save the Children ka ndërtuar një ekip multidisiplinar që përfshin stafin e qendrave për shërbime me bazë komunitare, shkollat, prindërit dhe përfaqësuesit e shërbimeve vendore shëndetësore e sociale. Ekipet janë përgjegjëse për vlerësimin e nevojave të fëmijëve si dhe për ndjekjen e planeve të tyre të zhvillimit.

Planet e zhvillimit të fëmijëve janë ndërtuar mbi vlerësimin e motivimit, vetvlerësimit, nevojave të zhvillimit konjitiv dhe emocional, nevojave arsimore dhe zhvillimit motorik. Në këtë mënyrë ata hartojnë tërësinë e shërbimeve që një fëmijë mund të këtë nevojë, duke filluar nga ndërhyrjet individuale deri tek terapitë e familjes apo shërbimet me bazë komunitare.

Kjo praktikë është gjithashtu në përputhje me axhendën e reformës për mbrojtjen sociale në vend që synon ngritjen e shërbimeve mbështetëse për t'ju përgjigjur nevojës së fëmijëve me aftësi të kufizuara për gjithëpërshirjen në arsimin.

Rast ilustrues

Praktikat e integruara shkollë-komunitet

Suada, një vajzë dhjetë vjeçare, ishte diagnostikuar me prapambetje të lehtë mendore. Rasti i saj u referua nga mësuesja tek qendra komunitare në Durrës disa muaj më parë. Ajo ishte në klasën e dytë të shkollës fillore dhe e dashuronte shkollën, por ajo kishte vështirësi në fushën akademike për faktin se ajo nuk fliste dhe nuk përqëndrohej dot. Kjo bënte që ajo të merrte pjesë gjithnjë e më pak në mësim.

Kur Suada filloi të shkonte në qendër, ajo mezi shqiptonte disa fjalë. Ajo nuk i bashkonte dot shkronjat dhe numrat me figurat e tyre korrespondues. Ajo nuk i dallonte dot ngjyrat dhe nuk shprehte interes në komunikim, për lodrat, objektet përqark apo terapitë që i ofroheshin asaj.

Sapo filloi të vinte në qendër, stafi i qendrës, mësuesit dhe nëna e saj u ulën sëbashku të diskutonin rreth nevojave që kishte Suada.

Plani i zhvillimit të Suadës u hartua nga një ekip multidisiplinar i përbërë nga terapisti i të folurit dhe psikologia e qendrës, prindërit e saj, mësuesja dhe psikologia e shkollës. Si rezultat i ndërhyrjes shumë intensive, të folurit e Suadës u përmirësua ndjeshëm. Ajo filloi të njihte mirë shkronjat dhe numrat dhe fjalori i saj u rrit ndjeshëm. Suada u bë më aktive në komunikim dhe filloi të bashkëpunonte me dëshirë në aktivitet kognitive në shkollë dhe qendër. Asaj i pëlqen shumë të kërcejë dhe të këndojë këngët e saj të preferuar në festat dhe aktivitetet e klasës.

Nëna e Suadës është shumë e lumtur me progresin që vajza e saj ka bërë dhe është e sigurt tashmë për zhvillimin e Suadës në të ardhmen. Ajo informahet rregullisht për zhvillimet e vajzës por edhe për mënyrën se si duhet të punojë me të në shtëpi. Ajo e ndihmon Suadës të bëjë aktivitetet e saj ditore dhe ndan eksperiencën dhe njohuritë që ajo ka fituar edhe me prindërit e fëmijëve të tjerë gjatë takimeve që organizohen në qendër.

4.6. Praktika të mira të shërbimeve me bazë komunitare përsa i përket pjesëmarrjes së prindërve

Projekti i 'Qendrave për shërbime me bazë komunitare për fëmijët më aftësi të kufizuara', i zbatuar në bashkëpunim me organizatën lokale 'Ndihmoni Jetën' dhe bashkitë Durrës dhe Vlorë nuk është ndalur vetëm në punën me FAK.

Një nga objektivat e punës së projektit ka qenë puna me prindërit, për informimin, fuqizimin dhe organizimin mes tyre për të mbështetur zhvillimin e fëmijëve të tyre, për të lobuar dhe advokuar për të drejtat e fëmijëve dhe për të bërë presion mbi institucionet vendore me qëllim shtimin e shërbimeve dhe mbështetjen për këtë kategori sociale.

> *Si prindër, kemi 2 vjet që marrim trajnime për të punuar me fëmijët tanë. Janë shërbime falas që në kushte të tjera do të ishin të pamundura për ne. Falë punës në këtë qendër jemi organizuar dhe po punojmë me Drejtorinë Arsimore për vendosjen e mësuesve ndihmës për fëmijët tanë. Qendra ka ndihmuar në organizimin e prindërve në Task Forcë për të lobuar pranë bashkisë për shtimin e buxhetit për AK* – thotë një nga prindërit, fëmija e të cilit frekuenton qendrën e Durrësit.

> *Nëna e vajzës A, 11 vjec, me prapapmbetje të lehtë mendore shprehet se vajza ka filluar të flasë falë punës së bërë në qendër por edhe trajnimit që unë si prind kam marrë për të punuar me vajzën.*

Drejtoresha e shërbimit social në Bashkinë Durrës shprehet se

> *'Prindërit janë bërë pjesë e rëndësishme e funksionimit të qendrës. Ata janë trajnuar dhe organizuar në Task Force për të lobuar për të drejtat e fëmijëve të tyre. Kjo është një eksperiencë e re edhe për ne'.*

Drejtoresha e shërbimit social në Bashkinë e Vlorës thekson anën tjetër të situatës. Ndonëse këto qendra ofrojnë shërbim dhe mbështetje edhe për prindërit, duhet pranur se '*Jo të gjithë prindërit marrin informacion për fëmijët, kjo për arësye se nuk munden të përballojnë gjithë ngarkesën e problemeve të tyre. Duhet më shumë punë me ta për t'i përfshirë në aktivitetin e qendrave'.*

Psikologët e shkollave janë më shumë të lidhur me efektin e drejtëpërdrejtë të punës me prindërit. Ata janë në gjendje të vlerësojnë se puna e bërë në qendra jo vetëm me fëmijët, por edhe më prindërit e tyre, ka sjellë ndryshime të rëndësishme tek fëmijët.

> Një nga psikologet e shkollave në Vlorë do të shprehej: '*Ky shërbim ka sjellë ndryshime të mëdha në punën me fëmijët por edhe me prindërit. Në mënyrë të veçantë, është një shërbim që ndihmon prindërit e fëmijëve me problem ekonomike'.*

> Një tjetër do të vinte në dukje: *'Prindërit janë ndikuar nga shërbimi dhe janë më pozitivë dhe më aktivë në zgjidhjen e problemeve të tyre'.*

Po prindërit vetë si e vlerësojnë ndihmën dhe shërbimin që kanë marrë nga këto qendra?

Në fokus grupin me prindërit në Vlorë, ata theksuan se:

> *'Kemi njohur më mirë problematikat e FAK; Kemi shkëmbyer eksperiencat; Kemi marrë trajnime: advokaci, lobim, të drejtat e fëmijëve, çrregullimet e spektrit autik, çështje të dhunës dhe neglizhimit; Kemi shkarkuar stresin; Kemi bërë aktivitete; Kemi ngritur Task Force për të zgjidhur problemet e fëmijëve tanë'.*

Ata janë në gjendje të rreshtojnë disa përfitime që kanë patur nga bashkëpunimi me qendrën, ndonëse nuk lënë pa përmendur edhe faktin se '*Nuk jemi ftuar në diskutimet e bashkisë për hartimin e buxhetit'(prind në Vlorë).*

> *'Prindërit e fëmijëve që frekuetojnë qendrën kanë shumë probleme ekonomike dhe ata kanë nevojë për mbështetje, veçanërisht nga bashkia për punësim'.*

Rast ilustrues

> *Rasti që po paraqesim në vijim është rasti i një familjeje me probleme të mëdha ekonomike dhe sociale, me një kryefamiljar që abuzonte me përdorimin e alkoolit.*
>
> *Vajza e tyre, B, e diagnostikuar me Çrregullim te Spektrit Autik, merrte shërbim në qendër. Nëna e saj, një 30 vjecare e papunë, e drobitur nga fati dhe shëndeti, kërkoi ndihmën e psikologes për këshillim në lidhje me situatën e rënduar në familje. Pas seancave të vazhdueshme, ajo sot deklaron se dinamikat në familje kanë ndryshuar. Eshtë rritur komunikimi mes bashkëshortëve dhe konfliktet po vijnë duke u shuar. Babai i fëmijës ka filluar të ulë sasinë e konsumit të alkoolit. Kjo ka bërë që fëmijët të jenë më të qetë dhe ndihen më të sigurt kur babai vjen në familje dhe nuk shkakton konflikte.*
>
> *Babai vjen herë pas here në qendër për të sjellë edhe marrë vajzën. Ai nuk ngurron të ndalojë para zyrës së psikologes dhe ta përshëndesë.*

Prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara janë shumë të kënaqur me shërbimin e ofruar deri më tani dhe nuk ngurrojnë të shprehin vlerësimin e tyre për mbështetjen që qendrat ju kanë dhënë atyre dhe fëmijëve të tyre.

4.7. Praktika të mira të shërbimeve me bazë komunitare në aspektin e investimit për përmirësimin e kapaciteteve të profesionistëve

> Drejtuesja e 'Ndihmoni Jetën' vlerëson faktin se '*Projekti ka siguruar mbështetje për të gjithë aktorët e përfshirë (mësuesit, mësuesit ndihmës)'*

> *'Tashmë mësuesit dhe mësuesit ndihmës në këto dy bashki ndihen të mbështetur në punën me fëmijët me aftësi të kufizuara'.*

Qendrat e shërbimit me bazë komunitare për fëmijët me aftësi të kufizuara në Durrës dhe Vlorë vlerësohen përtej mbështetjes që ato japin drejtpërsëdrejti për fëmijët me AK dhe prindërit e tyre.

> Psikologët e shkollave si profesionistë të lidhur me shërbimin e ofruar shprehen se '*Qendra është kthyer në një institucion tashmë për FAK'(psikologët e Durrësit).*

> *'Është jo vetëm qendër për fëmijët, por edhe për prindërit. Psikologët marrin gjithashtu shërbime. Janë organizuar disa trajnime për ta'(psikologët e Vlorës).*

> *'Ne i shohim si partnerë për referimin e fëmijëve dhe prindërve të tyre. Bashkëpunimi me qendrën është i rëndësishmë për ne' (psikologët e Durrësit)*

Madje disa prej tyre nuk ngurrojnë të shprehen se kanë frikë se kalimi i qendrave nën juridiksionin e bashkisë mund të cënojë pikërisht mundësinë që ato ju kanë dhënë për rritjen dhe fuqizimin e kapaciteteve profesionale edhe atyre vetë.

Mësuesit ndihmës në Vlorë vlerësojnë faktin se '*Qendra ofron trajnime për të rritur kapacitetet e mësuesve ndihmës, psikologëve dhe prindërve*'. Ata shprehen se pa qendrën përgatitja e tyre profesionale vihet në dyshim. Mundësitë e tyre për trajnime janë minimale ose të munguara. '*Qendra ka qenë si një rreze drite për ne*'- shprehen ato.

Qendrat e shërbimeve me bazë komunitare për fëmijët me aftësi të kufizuara në Durrës dhe Vlorë të ngritura nga Save the Children duket se kanë patur një ndikim shumë të madh në mesin e profesionistëve të fushës: mësues, mësues ndihmës, psikologë, terapistë, punonjës socialë, punonjës të shërbimit shëndetësor, punonjës të shërbimit social, ofrues të shërbimeve për të koordinuar shërbimet mes tyre por edhe për të rritur kapacitetet profesionale në një fushë relativisht të re të shërbimeve.

4.8. Praktika të mira të shërbimeve me bazë komunitare për FAK për fuqizimin e kapaciteteve të aktorëve vendorë dhe rritjen e bashkëpunimit mes tyre.

Për të mundësuar mbështetjen maksimale të fëmijëve në shkollë dhe në komunitet, Save the Children ka ngritur grupe multidisiplinare që përfshijnë stafin e qendrave komunitare, mësuesit/mësuesit ndihmës, prindërit dhe përfaqësuesit e shërbimeve sociale dhe shëndetësore në nivel vendor. Ekipet multidisiplinare janë përgjegjës për vlerësimin e fëmijëve, zhvillimin e tyre dhe ndjekjen e planeve të zhvillimit individual.

Projekti i Save the Children për ngritjen e qendrave komunitare për fëmijët me AK ka kontribuar edhe në ngritjen e rrjeteve të bashkëpunimit midis aktorëve lokalë.

> Sic shprehen shumë përfaqësues të institucioneve vendore '*rrjeti i ofruesve vendorë të shërbimeve, duke përfshirë autoritetet arsimore, përfaqësuesit e bashkisë, të shërbimit social, të shërbimit shëndetësor, anëtarë të komunitetit, përfaqësues të OJF-ve, informohen rregullisht mbi punën dhe nevojën e bashkëpunimit midis aktorëve. Kjo ka bërë që sistemi i menaxhimit të rastit të jetë efektiv dhe fëmijët të marrin një shërbim dhe mbështetje më të gjërë nga komuniteti*'.

Praktika e bashkëpunimit midis aktorëve vendorë po mbështet aktualisht 62 fëmijë nga mosha 6 deri në 12 vjeç, të cilët kanë vështirësi me zhvillimin, të nxënit, socializimin dhe integrimin. Kjo praktikë i përgjigjet edhe detyrimeve që burojnë nga procesi i reformimit të mbrojtjes sociale në Shqipëri, e cila synon t'ju përgjigjet nevojave për shërbime mbështetëse të përshtatshme që mund të sigurojnë përfshirjen e fëmijëve me AK.

> Drejtoresha e shërbimit social në Bashkinë e Durrësit thekson se falë qendrës '*Është ngritur dhe fuqizuar rrjeti i bashkëpunimit midis të gjithë aktorëve lokalë. Ne ndihemi të lidhur me njëri tjetrin. Kemi ku dhe si të referojmë rastet. Kjo ka çuar edhe në rritjen e ndërgjegjesimit të komunitetit për nevojat e fëmijëve me AK*'.

> '*Save the Children ka ndikuar tek modeli i partneritetit të organizatave lokale me njësitë e qeverisjes vendore. Komunikimi mes tyre është përmirësuar ndjeshëm*'- thotë drejtoresha e shërbimit social në Bashkinë e Vlorës.

Stafi i qendrës së Durrësit nënvizon se –*'Ndonëse disa shërbime ekzistonin, njësitë e qeverisjes vendore, institucionet publike dhe private, kishin nevojë të lidheshin dhe organizoheshin për një shërbim më të mirë ndaj FAK, dhe kjo u arrit falë rolit ndërmjetësues të qendrës sonë'.*

Drejtoresha e drejtorisë së shëndetit publik në Vlorë thekson se *'Kjo qendër është një pikë kontakti shumë e rëndësishme. Është asset për Vlorën. Është e para e këtij lloji jo vetëm pa pagesë por edhe në rolin e koordinatorit midis aktorëve lokalë'.*

Psikologët e shkollave Vlorë vënë në dukje se *'Qendra organizon fushata sensibilizimi të komunitetit për çështjet e AK duke bërë bashkë të gjithë aktorët lokalë'*

Rast ilustrues

Gjatë zhvillimit të nje aktiviteti ndërgjegjesues/informues në shkollën "Marie Kaçulini", klasa e I-rë, në të cilën ndjek mësimin një prej fëmijëve që merr shërbim në qendrën tonë, u evidentua rasti i një djali që refuzonte shoqërinë me fëmijën me AK. Nuk e pranonte në lojë dhe nuk e lejonte që t'i prekte mjetet e tij.

Pak muaj pas zhvillimit të aktivitetit në këtë klasë, nëna e fëmijës me AK u shpreh se aktiviteti kishte patur impakt pozitiv tek fëmijët dhe sidomos tek djali refuzues i përmendur më sipër. Sot ai luan me të, e ndihmon në mësime si dhe ndajne mjetet e punës bashkë.

Personeli i qendrës së Vlorës ndalet tek roli i tyre në komunitet, *'Puna jonë është e shtrirë edhe në komunitet, lidhja me shkollat, DAR, DSHP, Shërbimi social, Zyrat e punës, World Vision, Kurset profesionale, etj jo vetëm na ka lidhur me partnerët e tjerë por në fakt ne jemi kthyer në faktor kyç për t'i bërë bashkë e për t'i mbajtur bashkë të gjithë partnerët'.*

'Qendra është kthyer në pikë referimi dhe bashkëpunimi për të gjithë aktorët lokalë'.

'Marrëdhënia me institucionet e qeverisjes vendore është bërë më pozitive'.

'Përveç lidhjes midis aktorëve vendorë, krijimit të rrjetit të aktorëve lokalë, shërbimi në qendër ka gërshetuar edhe një sërë problematikash sociale'.

Një nga përfaqësueset e Save the Children vë në dukje se *'Shërbimi i ofruar në këto dy qendra ka gërshetuar një sërë çështjesh të lidhura midis tyre siç janë të drejtat e njeriut, të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, çështjet e antidiskriminimit, probleme të gjithë përfshirjes në arsimin e detyrueshëm, përpjekjet për eleminimin e formave të abuzimit dhe neglizhimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara, çështje të seksualitetit të tyre, etj.*

'Qendrat janë bërë pjesë e hartimit të planit social të dy bashkive'.

4.9. Shqetësime dhe sugjerime

4.9.1. Shqetësime

Aktorët e intervistuar për të bërë vlerësimin e praktikave më të mira të ofruara nga projekti Shërbimet me bazë komunitare për fëmijët me aftësi të kufizuara kanë vënë në dukje edhe disa shqetësime të cilat ne mendojnë t'i sjellim në formë të përmbledhur si pjesë e këtij vlerësimi:

- Aktorët janë skeptikë rreth të ardhmes së qendrave nën juridiksionin e bashkive. Nisur nga eksperiencat e mëparshme, aktorët ju tremben ndërhyrjeve të bashkive për të shkurtuar staf, për të ndryshuar staf dhe për të cënuar aktivitetin e qendrave.
- Aktorët tremben se me kalimin e qendrave nën juridiksionin e bashkive, situata financiare do të vështirësohet dhe kjo do të cënojë cilësinë e punës në qendra duke ndikuar tek varfërimi i bazës materiale, mungesa në mjetet e punës, mungesa të tjera që ndërhyjnë tek cilësia e punës si trajnime, aktivitete sensibilizuese, material për konsum publik, etj.
- Aktorët e intervistuar shprehen se angazhimi i bashkive në ofrimin e shërbimeve sociale është një hap pozitiv por këto shërbime kanë nevojë për monitorime për të ruajtur fokusin e punës dhe cilësinë e shërbimit.

4.9.2 Sugjerime

Për përmirësimin e mëtëjshëm të modelit të qendrave të shërbimeve me bazë komunitare për fëmijët me aftësi të kufizuara në rast të replikimit të tyre në qytete të tjera apo edhe në të njëjtët qytete, aktorët e intervistuar kanë sugjeruar:

- Rritje të numrit të profesionistëve në të dy qendrat;
- Përfshirje të specialistëve të tjerë – mjek stamotolog;
- Shtim i oreve të punës individuale me fëmijët nga 1-2 orë në javë deri në 4-5 orë në javë;
- Shtim i orëve të punës në grupe dhe aktiviteteve socializuese;
- Shtim i aktivitete sportive dhe i bazës materiale përkatëse;
- Shtim i aktiviteteve artistike;
- Ngritja e këndit të lojrave në natyrë;
- Ngritja e këndit të gjelbërt;
- Ngritja e këndit të kafshëve;
- Parashikimi i kurseve për punë dore, IT apo aktiviteteve të tjera me interes për fëmijët;
- Qendrat duhet të luftojnë të mbeten pika fokale për AK;
- Qendrat duhet të vazhdojnë të operojnë dhe mundësisht të shtohen në këto qytete dhe në qytete të tjera.

5. PËRFUNDIME

Studimet e fundit dhe të dhënat e Shërbimit Social Shtetëror tregojnë se 10,4% e fëmijëve të grupmoshës 2-17 vjeç hasin të paktën një vështirësi të lartë për të kryer një aktivitet ose nuk arrijnë ta kryejnë fare atë.

Janë të identifikuar 18,474 fëmijë me aftësi të kufizuara. Kjo shifër është rritur gradualisht me kalimin e viteve.

Studimet tregojnë gjithashtu se vetëm 7,8% e fëmijëve me aftësi të kufizuara në Shqipëri marrin shërbim nga qendrat sociale.

Prevalenca është më lartë në familjet me të ardhura të pakta. 66% e fëmijëve me aftësi të kufizuar jetojnë në familje me të ardhura të ulëta, ndërsa 30% e tyre jetojnë në familje me të ardhura mujore të mesme.

Niveli i papunësisë së prindërve të fëmijëve me aftësi të kufizuar raportohet mjaft i lartë. 58% e nënave dhe 33% e baballarëve janë të papunë.

55,0% e prindërve raporton se shpenzimet e nevojshme për marrjen e shërbimit për këta fëmijë janë të papërballueshme, ose krejtësisht të papërballueshme për ta.

Bashkia e Durrësit dhe e Vlorës janë ndër bashkitë me numrin më të lartë të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe me mungesë shërbimesh për mbështetjen e fëmijëve dhe prindërve të tyre.

Qendrat e shërbimeve me bazë komunitare për fëmijët me aftësi të kufizuara janë shumë të nevojshme në qytetet në fjalë.

Projekti i Save the Children për ngritjen e qendrave të shërbimeve me bazë komunitare për fëmijët me aftësi të kufizuara në bashkëpunim me organizatën Ndihmoni Jetën dhe bashkitë e Durrësit dhe Vlorës është një model risi në shërbimet komunitare.

Shërbimi gërsheton punën individuale me fëmijët me aftësi të kufizuara, me punën me prindërit për informimin dhe anagazhimin e tyre në mbrojtje të të drejtave të fëmijëve të tyre dhe punën me partnerët lokalë për rritjen e kapaciteteve vendore në trajtimin e cështjeve të aftësisë së kufizuar.

Shërbimi është i plotë pasi ai gërsheton një tërësi ndërhyrjesh për fëmijët duke filluar me terapitë individuale, punën në grup, fizioterapinë, etj.

Modeli i ofruar siguron qëndrueshmëri të shërbimit pasi bashkitë e Durrësit dhe Vlorës kanë një marrëveshje bashkëpunimi me Save the Children, marrëveshje kjo që ka siguruar angazhimin gradual të bashkive për të marrë nën juridiksion shërbimin e qendrave pas përfundimit të projektit. Aktualisht bashkitë përvec se kanë vënë në dispozicion mjediset e qendrave, kanë filluar të mbulojnë edhe shpenzimet për pagat e disa punonjësve të qendrave (bashkia e Durrësit) dhe të paguajnë disa kosto administrative (bashkia Vlorë).

Modeli i ofruar mundëson aksesin e shërbimeve nga fëmijë të familjeve me probleme ekonomike, pasi shërbimi është falas.

Qendrat e shërbimeve janë të vendosura në zemër të zonave të banuara duke e afruar shërbimin pranë njerëzve në nevojë.

Shërbimi i ofruar nga qendrat për shërbime me bazë komunitare për fëmijët me aftësi të kufizuara përbën një komponent të rëndësishëm në fushën e AK pasi i bashkëngjitet përpjekjeve për realizimin e arsimit gjithëpërfshirës. Shërbimet në qendra kanë përmirësuar ndjeshëm vijueshmërinë në shkolla të fëmijëve që ndjekin qendrat.

Qendrat e shërbimit me bazë komunitare për fëmijët me aftësi të kufizuara në Durrës dhe Vlorë janë kthyer në qendra të punës me prindërit për informimin, trajnimin dhe organizimin e tyre për të lobuar dhe advokuar në mbrojtje të të drejtave të fëmijëve të tyre. Tashmë prindërit në të dy qendrat kanë TASK Forcen dhe Bordin e tyre dhe janë duke bërë presion mbi bashkitë për buxhetin social.

Qendrat janë kthyer në epiqendra të rrjetit të akotrëve lokavë, qofshin këto publike apo jopublike.

Qendrat kanë investuar për rritjen e kapaciteteve profesionale të aktorëve lokalë (qeverisjes lokale por edhe profesionistëve - mësues, mësues ndihmës, psikologë, punonjës socialë, mjeke, etj) .

Qendrat janë një përpjekje serioze për të plotësuar detyrimet që burojnë nga dokumentat ligjorë dhe politikë në vend për zbatimin e të drejtave të PAK, veçmas të FAK.

6. REKOMANDIME

A. Qeverisja Qendrore:

Duhet të inkurajojë përmes politikave, strategjive dhe programeve ngritjen e shërbimeve të tilla gjithëpërfshirëse, multidisiplinare dhe të bashkërenduara edhe në qytete të tjera të vendit.

Duhet të këmbëngulë në përmbushjen e detyrimeve që burojnë nga ratifikimi i dokumentave ndërkombëtare për AK duke i nxitur strukturat lokale të përmbushin detyrimet ligjore.

Duhet të hartojë standarte për ofrimin e shërbimeve specifike, sipas nevojave të grupeve sociale, duke këmbëngulur tek rritja e kapaciteteve të profesionistëve dhe e strukturave qendrore e vendore.

B. Qeverisja Vendore:

Duhet të marrë përsipër përgjegjësitë për mbështetje me shërbime për grupet në nevojë.

Duhet të planifikojë rregullisht buxhetin social në përputhje me nevojat e komuniteteve që përfaqësojnë.

Duhet të angazhohen në mbështetjen e qendrave të ngritura nga Save the Children, dhe mundësisht të planifikojnë edhe ngritje të qendrave të tjera në zonat me nevoja të shumta.

Duhet të forcojë partneritetin me organizatat e shoqërisë civile dhe bisnesin lokal që mund të kontribuojnë në ploteësimin e nevojave të FAK.

Duhet të monitorojë bashkëpunimin e partnerëvë lokalë në plotësimin e nevojavë të fëmijëve me aftësi të kufizuar duke inkurajuar bashkëpunimin midis tyre.

C. Organizata e shoqërisë civile:

Në bashkëpunim më aktorët e tjerë të mundësojnë ngritjen e shërbimeve të tjera për FAK.

Të bashkëpunojnë më organet e qeverisjes vendore për hartimin e buxhetit dhe rritjen e peshës së buxhetit social.

Të bashkëpunojnë me aktorët e tjerë vendorë, institucione publike dhe jo publike, për të konsoliduar rrjetin e shërbimeve në vend.

Të identiofikojnë burime të tjera për shtimin e shërbimeve, donatorë vendas dhe të huaj që mund të kontribuojnë për pasurimin eshërbimeve për FAK.

D. Save the Children

Të mundësoj ë një fazë të dytë të projektit për monitorimin e shërbimit të qendrave me synim ruajtjen e cilësisë së shërbimit.

Identifikimin e donatorëve për të mundësuar ngritjen e qendrave të tilla edhe në qytete të tjera me nevoja të mëdha për FAK.

BIBLIOGRAFIA

Analiza e situatës së shërbimeve për fëmijët me aftësi të kufizuara, Save the Children, Tiranë 2016, Shqipëri.

KAP Survey Baseline Report of the Project "Community Based Services for Children ëith Disabilities", Save the Children, Tirane 2017, Albania.

Situata e zbatimit të shërbimeve për fëmijët me aftësi të kufizuar në nivel lokal: Dokument orientues i ndërhyrjeve, në drejtim të përmirësimit të gjendjes së shërbimeve shoqërore dhe shëndetësore për komunitetin e personave me aftësi të kufizuara, FSHDPAK&World Vision, Maj 2018.

Guideline Paper on interventions for improvement of the situation in the field of education for children with disabilities, FSHDPAK&World Vision, January 2018.

Inclusive Education for Children with Special Education Needs in Albania, Save the Children, Tirana 2017.

Ligji për arsimin parauniversitar Nr 69, 2012/I ndryshuar

Ligji Nr. 658, datë 17.10.2005, "Për standartet e shërbimeve shoqërore"

Ligji Nr. 9355, datë 10.03. 2005, "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore/i ndryshuar".

Rishqyrtimi i Sistemit të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar në Shqipëri, UNICEF, maj 2015.

VKM 658, datë 06.12.2006, "Për standartet e përkujdesit shoqëror për personat me aftësi të kufizuara në qendrat rezidenciale dhe ditore".

Udhëzim i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Nr. 38, datë 07.10.2014, "Për kriteret e punësimit të mësuesve ndihmës për nxënësit me aftyësi të kufizuara në institucionet e arsimit public parauniversitar".

Udhëzim Nr. 38, datë 13.08.2013, "Për arsimin e individëve të moshës shkollore në institucionet e përkujdesjes shoqërore".

INSTAT, Profili i personave me aftësi të kufizuara në Shqipëri, 2015.

Progres Raporti i parë i Qeverisë së Shqipërisë për Zbatimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, Maj 2015.

VKM nr.483, datë 29 qershor 2016, "Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të kufizuara, 2016-2020".

VKM Nr. 1071, datë 23.12. 2015, "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të të Mbrojtjes Sociale, 2015-2010".

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 87, datë 3.2.2016, "Për miratimin e Dokumentit Politik të Përfshirjes Sociale 2016–2020".

Ligji nr. 93/2014 datë 28.07.2014, "Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara".

Ligji Nr.121, datë 21.11.2016, "Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë"

Save the Children

Rruga: Mihal Popi, Ndërtesa 7, ish Pallatet 1 Maji, (Vila Lami);
PO Box 8185, Tiranë - Shqipëri; Tel: +355 4 2261840/ 4 2261929
E-mail: info.albania@savethechildren.org
https:// albania.savethechildren.net
Savethechildrenal SaveChildrenAlb